

VËRTETËSIA

Botim i XhemaTit Musliman Ahmedia të Shqipërisë

Nr.9

PROFECITË PËR KOHËT TONA

Bismil-laħirrahmanirrahim
Komentim i Kuranit
Famëlartë

4

Le të harrohet o miq
mendimi mbi xhihadin!
(Poezi)

34

Nevoja për të kërkuar
besimin dhe XhemaTin e
Zotit

34

Dexhalli dhe ardhja e
Mesihut të Premtuar^{ms}

48

Tani, çdo të premtë...

ndiqni fjalimin e xhumasë në shqip,
të mbajtur nga Hazret Kalifi i Pestë
i Mesihut të Premtuar.

Vizitoni: www.alislam.al



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

عِلْمُ الْغَيْبِ فَلَا يُظْهِرُ عَلَى غَيْبِهِ أَحَدًا ۝
إِلَّا مَنِ ارْتَضَىٰ مِنْ رَسُولٍ فَإِنَّهُ يَسْلُكُ
مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ رَصَدًا ۝

Ai është
Njohësi i së padukshmes.
Pra, Ai nuk i tregon të
padukshmen e Tij askujt,
përveç ndonjë të dërguari
të Tij të zgjedhur.
Më pas, sigurisht,
Ai ecën si mbrojtës
para dhe pas tij.


(Kurani Famëlartë 72:27-28)

VËRTETËSIA

numri IX

një hap më pranë argumentit dhe rrugës së drejtë


PËRMBAJTJA



4



16



34



48

- 4 ***Bismil-labirrahmanirrahim***
Komentim i Kuranit Famëlartë
Nga Hazret Mirza Mahmud Ahmedî^{ra}, Kalif II i Mesihut të Premtuar
- 15 **Falja është në dorën e Zotit**
Hadith i Profetit Muhammed^{savs}
- 16 **Lideri musliman: OKB të luajë rolin e saj pa u ndikuar nga politika, padrejtësia dhe favorizimi**
Raport mbi fjalimin historik të Udhëheqësit të Xhematit Musliman Ahmedia në Parlamentin e Kanadasë
- 30 **Le të harrohet o miq mendimi mbi xhihadin!**
Hazret Mirza Ghulam Ahmedî, Mesih i Premtuar, Imam Mehdi^{as}
- 34 **Nevoja për të kërkuar besimin Thënie të Hazret Imam Mehdiut, Mesihut të Premtuar^{as}**
- 38 **Disa nga profecitë e Profetit Muhammed^{savs} për kohët tona**
Dr. Mirza Sultan Ahmad
- 48 **Dexhali dhe ardhja e Mesihut të Premtuar^{as}**
Samad Ghori
- 58 **Ajete të Kuranit Famëlartë Paralajmërimi për kohët tona**
- 62 **Profecia e Mesihut të Premtuar^{as} për luftërat botërore**
- 64 **Si e kuptoni “Vulën e profetëve”? Ku qëndron dallimi**



38



në botëkuptimin tuaj dhe të muslimanëve të tjerë për këtë çështje?

Transkriptimi i një sesioni pyetje-përgjigjesh të mbajtur nga Hazret Mirza Tahir Ahmedi^{ra}, Kalifi IV i Mesihut të Premtuar

74 Kalifati i drejtë dhe rivendosja e tij

Bujar Ramaj

87 Xhelsa Salana e 9-të e Xhematit Musliman Ahmedia të Shqipërisë

93 Xhelsa Salana e 5-të e Xhematit Musliman Ahmedia të Kosovës

99 Përmbajtja në anglisht

Kryeredaktor:

Samad Ghori

Redaktor gjuhësor:

Besmir Yvejsi

Anëtarë:

Jinahuddin Saif

Bujar Ramaj

Imer Gjergji

Grafika:

Imer Gjergji & petanidesign

Shtypur në shtypshkronjën:

Gent•grafik

Tiranë, mars 2017

Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë, pranë Vodafonit, Rr.

“Pavarësia” Km. 1, Mëzez,
Kutia Postare 8176, Tiranë,
Shqipëri

M +355 67 216 8054;

+377 44 817 813

T +355 42 391 080

Fax: +355 42 391 081

E-mail:

Kontakto në www.alislam.al


www.alislam.al

www.vertetesia.al

Bismil-lahirrahmanirrahim

Komentim i Kuranit

nga *Hazret* Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed^{ra}



Pjesë e shkëputur nga komentimi i ajetit

“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit”




Image: © Habib M'henni | Wikimedia Commons

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Bismil-labirrahmanirrahim

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit

Bismil-lahu në krye të çdo sureje është shkruar sipas shpalljes së Zotit

Të gjitha *suret* e Kuranit fillojnë me *bismil-labirrahmanirrahim*, përveç sures Bera'et, por pohimi më i saktë rreth saj është që ajo nuk është sure

më vete, por është pjesë plotësuese e sures El-Enfal, andaj, ajo nuk fillon me *bismil-lab* të ri.

Në Sunen të Ebu Davudit përmendet një rrëfim nga Ibni Abasi^{ra}, i cili thotë:

أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ كَانَ لَا يَعْرِفُ فَصْلَ السُّورَةِ حَتَّى يَنْتَوِلَ عَلَيْهِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ.

“Pa zbritjen e bismil-labut, i Dërguari i Allahut^{savs} nuk quante shpalljen si sure të re”.

(Sunen Ebu Davud, Kitab “Es-Salat”, Bab “Men xhehere bi bismil-lahirrahmanirrahim”, hadithi nr. 788)

Pra, pas përfundimit të një sureje, surja e re fillonte të zbritej me zbritjen e *bismil-labut*. Këtë rrëfim e sjell edhe Hakimi në Mustedrekun e tij.

(Mustedrek El-Hakim, Kitab “Es-Salat”, Bab “Et-Te'min”, hadithi nr. 845)

Ky hadith tregon se para çdo sureje të re, zbriste *bismil-labu* dhe fundi i sures së vjetër kuptohej vetëm kur zbriste *bismil-labu* i një sureje të re. Andaj, kur nuk zbriti *bismil-labu* para sures Bera'et, nënkuptohet që

ajo nuk është ndonjë sure e re, por është pjesë e sures El-Enfal.

Ky hadith gjithashtu provon se *bismil-labu* që përmendet para çdo sureje, çdo herë ishte shpallur prej Zotit dhe si i tillë, ai është pjesë e Kuranit dhe jo diçka shtesë.

Rreth *bismil-labut* disa dijetarë menduan se ai nuk është pjesë e çdo sureje, por vetëm e sures El-Fatiha, ndërsa disa të tjerë thanë se ajo nuk është pjesë e asnjërës prej sureve të Kuranit. Por kjo nuk është e saktë. Këtë e hedh poshtë, në radhë të parë, hadithi që u citua më lart. Së dyti, ka shumë hadithe të tjera, në të cilat i Dërguari i Allahut^{savs} *bismil-labun* e quajti si pjesë të sureve të Kuranit. Për shembull, lidhur me faktin se ai është pjesë e sures El-Fatiha, Darakutni sjell një rrëfim nga Ebu Hurejre^{ra}, i cili thotë:

إِذَا قَرَأْتُمُ الْحَمْدَ فَاقْرَءُوا بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ،
إِنَّهَا أُمُّ الْقُرْآنِ، وَأُمُّ الْكِتَابِ، وَالسَّبْعُ الْمَثَانِي، وَبِسْمِ
اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ إِحْدَى آيَاتِهَا

I Dërguari i Allahut^{savs} tha: *“Kur recitoni Elhamdulil-lab-un, thoni edhe bismil-lahirrahmanirrahim, sepse El-*

Fatihaja është nëna e Kuranit, nëna e Librit dhe Shtatëvargëshi i përsëritur, ndërkohë bismil-lahirrahmanirrahim është njëri prej ajeteve të saj”.

(Darakutni, Bab “Vuxhub kira’eti bismil-lahirrahmanirrahim fis-salat”, hadithi nr. 1190)

Këtë rrëfim e ka sjellë edhe Imam Buhariu në librin e tij “Tarih”. (Fet’hul Bajjan, vëll. I)

Ky hadith tregon se *bismil-lahirrahmanirrahim* është pjesë jo vetëm e sures El-Fatiha, por edhe e sureve të tjera, sepse i Dërguari i Allahut^{savs} nuk tha vetëm se *bismil-lahirrahmanirrahim* është pjesë e El-Fatihasë, por dha argumentin se përse ai është pjesë e saj, duke thënë se El-Fatiha është nëna e Kuranit. Ky argument vlen edhe për të provuar se *bismil-lahu* është pjesë e sureve të tjera gjithashtu. Me fjalë të tjera, pohimi i të Dërguarit të Allahut^{savs} nënkupton se kur *bismil-lahu* është pjesë e sureve të tjera, përse nuk mund të jetë pjesë e El-Fatihasë, e cila është nëna e Kuranit.

Ka edhe argumente të tjera që e provojnë këtë fakt. Për shembull, në

Sahih të Muslimit përmendet:

عن انس قال، قال رسول الله ﷺ أنزلت على سورة
أنفأ فقرأ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ إِنَّا أَعْطَيْنَكَ
الْكَوْثَرَ -

*Enesi^{ra} rrëfen: I Dërguari i Allahut^{savs}
tha: Sapo më zbriti një sure e re e cila
është “Bismil-lahirrahmanirrahim.
In-na a’tajnakel-keuther”.*

(Sahih el-Muslim, Kitab “es-salat”, bab
“Huxheti men kalel-besmeletu ajetun min
eveli kul-li suretin”, hadithi nr. 899)

Pra, i Dërguari i Allahut^{savs} e cilësoi ajetin *bismil-lahirrahmanirrahim* si pjesë të sures El-Keuther. Rrëfime të ngjashme ka edhe për disa sure të tjera.

Dikush mund të ngrejë akuzë kundër këtij rrëfimi duke thënë se kjo sure është mekase, ndërsa Enesi është medinas dhe ishte 8 ose 9 vjeç, ndërkohë, fjalët e hadithit të japin përshtypje sikur i Dërguari i Allahut^{savs} i tha këto fjalë menjëherë pas zbritjes së sures. E nëse kjo është e vërtetë, si ka mundësi që Enesi mund t’i ketë dëgjuar këto fjalë?

Po të mos kishim prova të tjera mbështetëse të këtij hadithi, akuza e mësipërme pa dyshim që do ta dobësonte autenticitetin e tij. Por prania e provave të tjera e zhvlerëson akuzën. Në fakt, sahabët rrëfenin ngjarje të caktuara, nganjëherë, duke i dëgjuar edhe nga sahabët e tjerë. Të gjithë dijetarët e pranojnë që një hadith i caktuar, kur rrëfëhet nga ndonjë sahab, ai quhet i saktë, sepse për asnjë sahab të Profetit^{savs} nuk provohet që ai të ketë gënjer. Nëse Enesi^{ra} ia referon këtë thënie Profetit Muhammed^{savs}, me siguri ai duhet ta ketë dëgjuar nga ndonjë sahab muhaxhir. Andaj, mëdyshja në këtë hadith nuk qëndron.

Disa njerëz mendojnë se *ehnafët* (ndjekësit e Imam Ebu Hanifës) besojnë se *bismil-labu* nuk është pjesë e Kuranit Famëlartë. Por, kjo është e pavërtetë. Imam Ebu Hanife nuk besonte kështu, përkundrazi, besonte që *bismil-labu* është një ajet i mirëfilltë, por nuk është pjesë e sures.

Imam Ebu Bekr Razi që është njëri prej imamëve të hanefive, në pjesën e parë të librit të tij “Ahkamul-Kuran”, shkruan:

وَمَا ثَبَّتْ أَنهَا لَيْسَتْ مِنْ أَوَائِلِ السُّورِ وَأَنَّ كَانَتْ آيَةً فِي مَوْضِعِهَا عَلَى وَجْهِ الْفَصْلِ بَيْنَ السُّورَتَيْنِ أَمَرْنَا بِالْإِبْتِدَاءِ بِهَا تَبْرُكًا.

“Ngaqë u provua se ky ajet nuk është pjesë e ndonjë sureje, por është ajet i mirëfilltë që tregon ndarjen e dy sureve, jemi porositur ta themi për bekim përpara se të fillojmë namazin”.

Andaj, është vetëm padituri e atyre që thonë se *ehnafët* nuk e cilësojnë ajetin *bismil-lab* si pjesë të Kuranit. Pa dyshim që ata nuk e cilësojnë atë si pjesë të ndonjë sureje, por si pjesë të Kuranit patjetër që e cilësojnë. Megjithatë, sipas meje, edhe ky besim i tyre nuk është i saktë, sepse e vërteta është që *bismil-lahirrahmanirrahim* është pjesë e çdo sureje të Kuranit dhe, siç do të provohet në vazhdim, vendosja e këtij ajeti përpara çdo sureje është bërë me shumë urtësi.

Rëndësia e *bismil-lahut*

I Dërguari i Allahut^{savs} i dha rëndësi të veçantë *bismil-lahut*. Ai thotë:

كَلَّ امر ذى بال لا يُبدأ فيه بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
اقطع-

“Çdo punë e rëndësishme që nuk fillon me bismil-lahirrahmanirrahim, është e pabekuar”.

(Hafiz Abdul Kadir, Erbain, an Ebi Hurejre, marrë nga: Xhelaludin es-Sujuti, “Ed-durru menthur fi tefsiri bil-me’thur,” vëllimi I, Kairo, 1424 h./ 2003, fq. 45)

Vetë praktika e të Dërguarit të Allahut^{savs} na kërkon që të fillojmë çdo punë me *bismil-lahun*. Në një hadith përmendet:

أغلق بابك واذكر اسم الله عزَّ وِجَلَّ فَإِنَّ الشَّيْطَانَ لَا يَفْتَحُ بَابًا مَغْلَقًا وَأُطْفِئُ مَصْبَاحَكَ وَاذكُرْ اسْمَ اللَّهِ وَخَمِّرْ إِنْاءَكَ وَلَوْ بَعُدَ تَعَرَّضْ عَلَيْهِ وَاذكُرْ اسْمَ اللَّهِ وَأَوْكُ سِقَاءَكَ وَاذكُرْ اسْمَ اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ-

“Thuaj bismil-lah kur mbyll derën; kur shuan llambën; kur i vë kapakun enës; kur i vë tapën shishes”.

(Ahmed Ibn Hanbel, “Musned”, hadithi nr. 14434)

Gjithashtu, në hadithe të tjera thuhet që të thuash *bismil-lah* duke shkuar te bashkëshortja, duke marrë abdes, duke ngrënë bukë, duke hyrë në banjë, duke u veshur etj.

Në Kuran flitet për një letër të Hazret Sulejmanit^{as}, që ai e kishte shkruar me *bismil-lah*. Ajeti i Kuranit thotë:

إِنَّهُ مِن سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

“Pa dyshim, ajo (letër) është prej Sulejmanit dhe ajo është me bismil-lahirrahmanirrahim”.

(En-Neml 27:31)

Edhe për Hazret Nuhun^{as} përmendet në Kuranin Famëlartë që ai kishte porositur shokët e tij të anijes të luteshin duke thënë *bismil-lahun*:

بِسْمِ اللَّهِ مَجْرِبَهَا وَمُزْسَلَهَا إِنَّ رَبِّي لَعَفُورٌ رَّحِيمٌ

“Hipni në të dhe thoni: me emrin e Allahut është nisja e saj dhe qëndrimi saj”.

(Hud 11:42)

Përse *bismil-lahu* vjen para çdo sureje?

Bismil-lahu vjen para çdo sureje, sepse Kurani Famëlartë pohon se ai është një thesar, të cilin njeriu nuk mund ta hapë pa i kërkuar leje Allahut të Madhërishëm:

لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْأَمَّطُّهُزُونَ

“Atë nuk mund ta prekë askush, përveç atyre që janë të pastruar”.

(El-Vakia 56:80)

Pra, përveç atyre që i ka zgjedhur Zoti i Madhërishëm, të tjerët nuk mund të zbulojnë sekretet e Kuranit Famëlartë. Allahu i Madhërishëm gjithashtu thotë:

يُضِلُّ بِهِ - كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ - كَثِيرًا

“Ai, nëpërmjet Kuranit, shumë njerëz i devijon dhe shumë të tjerë i udhëzon”.

(El-Bekare 2:27)

Pra, në shkrim dhe në fjalë Kurani është njësoj për të gjithë, por në efekt është ndryshe. Lind pyetja: Çfarë duhet të bëjmë për ta zbuluar këtë thesar, për të pasur efekt pozitiv të tij dhe për t’u shmangur efektit të tij negativ? Përgjigjen e jep vetë

Kurani, duke na porositur:

إِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ

“Kur të recitoni Kuranin kërkojini mbrojtjen Allahut” (En-Nahl 16:99), dhe gjithashtu, duke vënë *bismil-lahirrahmanirrahim* para çdo sureje. Kjo do të thotë se para se të recitojmë Kuranin, së pari duhet t’i lutemi Zotit që të na mbrojë nga sulmet e shejtanit dhe, së dyti, t’i kërkojmë ndihmë nëpërmjet attributeve të tij *Rahman* dhe *Rahim*. Në këtë mënyrë ne do të shpëtojmë nga devijimi dhe do të gjejmë udhëzimin.

Ka edhe një arsye tjetër që tregon se përse *bismil-lahirrahmanirrahim* vjen para çdo sureje. Në Bibël përmendet një profeci për ardhjen e një profeti të ngjashëm me Musain⁴⁸, me të cilin Zoti do të kishte një sjellje të veçantë. Bibla thotë:

“Unë do të nxjerr për ta një profet nga gjiri i vëllezërve të tyre dhe do të vë në gojën e tij fjalët e mia, dhe ai do t’u thotë atyre të gjitha ato që unë do t’i urdhëroj. Dhe do të ndodhë që nëse dikush nuk i dëgjon fjalët e mia që ai thotë në emrin tim, unë do t’i kërkoj llogari”.

(Ligji i Përtërirë 18:18-19)

Sipas kësaj profecie, për të ngjashmin e Musait^{as} ishte caktuar që sa herë që ai do të sillte fjalët e Allahut të Madhërishëm, do të pohonte shprehimisht “*Unë këtë po jua them në emër të Zotit të Madhërishëm dhe jo nga ana ime*”. Pra, kjo profeci kërkonte që çdo sure e Kuranit të fillonte me *bismil-lahun*, në mënyrë që të përmbushej profecia e Hazret Musait^{as} në njërën anë dhe, në anën tjetër, t’u jepej argument hebrejve dhe të krishterëve se ata që nuk do ta dëgjonin këtë libër, sipas shpalljes së Musait^{as}, do të tërhiqnin ndëshkimin e Zotit.

Arsyeja e tretë se përse ky ajet është vendosur para çdo sureje, është përsëri një thënie e Biblës, që thotë:

“Por profeti që pretendon të thotë në emrin tim një gjë për të cilën unë nuk e kam urdhëruar ta thotë ose që flet në emër të perëndive të tjera, ai profet do të vritet”.

(Ligji i Përtërirë 18:20)

Sipas këtij vargu biblik, çdokush që gënjen në emër të Zotit duke thënë se është i dërguar, Zoti do ta shkatërrojë atë. Me *bismil-lahun*

para çdo sureje, hebrejve dhe të krishterët në veçanti dhe të gjithë të tjerët në përgjithësi ballafaqohen me argumentin se sukcesi dhe përparimi i Profetit Muhammed^{savs} edhe pas ekzistencës së një ligji të tillë të Zotit, tregon se çdo gjë që tha ai, ishte prej Zotit të Madhërishëm. Përndryshe, ai do të shkatërrohej. Shkurt, duke sjellë *bismil-lahun* para çdo sureje, sidomos hebrejve janë cilësuar plot 114 herë si fajtorë, dhe po aq herë Profeti Muhammed^{savs} është cilësuar si profet i vërtetë. Po të ishte *bismil-lahu* vetëm në fillim të Kuranit, nuk do të sigurohej ky përfundim.

Arsyeja e katërt e vendosjes së *bismil-lahut* para çdo sureje është reformuese. Lexuesi i Kuranit duhet të jetë në njërën prej tri gjendjeve: ai mund të jetë krejtësisht në padijeni, ose mund të ketë provokuar zemërimin e Zotit të Madhërishëm për shkak të ligësive që ka bërë dhe si i tillë mund të jetë i privuar nga ndonjë shtytje për t’i kërkuar bekimin Allahut, ose mund të jetë sakrifikues në rrugën e besimit.

Që të tre duhet të kenë ndjesi të ndryshme para se të lexojnë

Kuranin. I pari mund të jetë i hutuar, i dyti i zhgënjyer dhe i treti mund të mburret për atë që ka bërë. I pari do të jetë i hutuar sepse nuk do të kuptojë se ku mund të gjejë të vërtetën. I dyti do të jetë i zhgënjyer dhe i brengosur sepse nuk do të ketë fytyrë t'i kërkojë Zotit. Dhe i treti mund të jetë i ndikuar nga mendimi se ka arritur gjithçka që kishte për të arritur.

Të tria këto gjendje të zemrës, e privojnë njeriun që të përfitojë nga Kurani. Prandaj, në krye të çdo sureje është vendosur *Bismil-lahirrahmanirrahim*, në mënyrë që i padituri të udhëzohet se ekziston një Zot që bekon njerëzit, pa pasur ndonjë vepër prej tyre. I humburi për shkak të veprave të liga që ka bërë, të ngushëllohet se nuk ka nevojë të zhgënjehet, sepse Ai Zot që ka zbritur këtë sure, është i gatshëm t'i falë të gjitha mëkatet. Kurse të tretit, që është krenar për sakrificat e tij, i është tërhequr vërejtja që thesaret e mëshirës së Zotit janë të pakufishme dhe se ai si kërkimtar, nuk duhet të ndalet në asnjë vend, sepse edhe përparimet janë të pakufishme.

Kuptimet e Kuranit që mund t'ju hapen pas një reforme të tillë të zemrës, nuk mund t'ju vijnë përpara saj. Andaj, duke e vendosur këtë ajet para çdo sureje, Zoti i Madhërishëm na mundësoi një mjet shumë të fuqishëm për të zbuluar kuptimet e Kuranit.

Arsyeja e pestë se përse ky ajet është vendosur përpara çdo sureje është sepse ky është çelësi i çdo sureje. Të gjitha çështjet fetare e shpirtërore vërtiten rreth dy attributeve të Zotit, që janë *Rahman* dhe *Rahim*. Mundësia e keqkuptimit ekziston në dy rrafshë: 1) Keqkuptimi që del nga shpjegimi dhe 2) Keqkuptimi që del nga përmbledhja. Ndaj, Zoti i Madhërishëm përpara çdo sureje ka vendosur *bismil-lahun*, në mënyrë që për çdo kuptim që nxjerr lexuesi, ta analizojë atë nëse përputhet me atributet “i Gjithëmëshirshëm” dhe “Mëshirëbërës” apo jo. Nëse kuptimi që nxjerr lexuesi, përputhet me këto dy attribute, le ta pranojë, e nëse jo, le ta refuzojë. Në këtë mënyrë, *bismil-lahu* është përmbledhja dhe surja është shpjegimi i tij dhe të dyja bashkërisht, i japin lexuesit një vizion të qartë për kuptimet e tyre.

Rreth *bismil-labut* në librat e mëparshëm

Disa jomuslimanë akuzojnë: *Bismil-lahu* për të cilin ju krenoheni, gjendet edhe në librat e tjerë. Për shembull, në literaturën e Zarathustrës, thuhet:

بنام یزدان بخشائش گردا وار

Në persishten e re, kjo është përkthyer si vijon:

بنام خداوند بخشاینده بخشائش گر

(Komentimi nga Revrend Very)

Ose thonë se edhe hebrenjtë kanë pasur traditën e *bismil-labut* dhe nga ata ai ka hyrë edhe tek arabët dhe i pari që e futi në traditën arabe, ishte kryetari i Taifit. (Përkthimi i Kuranit nga Rodwelli)

Duke iu përgjigjur Rodwellit, duhet thënë se kjo është plotësisht e pavërtetë që arabët kanë pasur traditën e *bismil-labut* të tillë. Madje, ata nuk dëshironin as ta përmendnin atributin *Rahman* (I Gjithëmëshirshëm). Pra, pretenduesit kanë për detyrë të paraqesin argumentin historik, gjë që nuk ekziston.

Për sa i përket akuzës ku thuhet se edhe hebrenjtë e kanë pasur si traditë *bismil-labun*, duhet sqaruar se nëse pretendohet që hebrenjtë e kohës së Profetit Muhammed^{savs} ose të një kohe të afërt me të, e përmendnin *bismil-labun*, ose historia e tyre e dëshmon këtë, kjo absolutisht nuk është e vërtetë. Por, nëse pretendohet që vetë Sulejmani^{as} e përmendi *bismil-labun* në letrën e tij, atëherë një akuzë e tillë vjen nga mungesa e sinqeritetit, sepse përdoret referenca e Kuranit për ta akuzuar Kuranin. Dihet që Kurani Famëlar^{as} thotë që në letrën që Hazret Sulejmani^{as} ia kishte dërguar mbretëreshës së Sebas, kishte shkruar edhe këtë fjali:

إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

“Kjo është prej Sulejmanit dhe kjo është në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit”.

(En-Neml 27:31)

Pas kësaj dëshmie, vetë akuza e tyre mbetet e pakuptimtë. Islami nuk pretendon se tema e këtij ajeti është paraqitur vetëm nga ai. Emrat si *Allah, Rahman, Rahim* etj. ekzistonin edhe para Islamit dhe përdroreshin.

Ajo që pretendon Islami është që përdorimi i këtij ajeti, siç është në Islam, nuk gjendej më parë. Nëse kundërshtarët e Islamit paraqesin dëshmi që e rrëzon këtë fakt, pa dyshim do t'i kushtojmë rëndësi një dëshmie të tillë, por ekzistenca e një dëshmie të tillë është e pamundur. Sepse nuk ka qenë asnjë libër përpara Kuranit Famëlartë që ka pretenduar se çdo fjalë e tij është prej Zotit të Madhërishëm. Andaj, përveç Kuranit Famëlartë, asnjë libër qiellor nuk meritonte që përpara çdo kapitulli të tij, të thuhej një fjali e tillë.

Për sa i përket përmendjes së emrave të Zotit për bekim në fillim të ndonjë letre ose ndonjë teme, kjo natyrisht që praktikohet. Këtë nuk e mohon as Islami e as muslimanët. Si muslimanët, ashtu edhe shumë jomuslimanë e kanë pasur këtë si traditë.

Kështu, një përgjigje e akuzës së ngritur nga Revrend Veri u shënuar më lart. Përgjigjja e dytë është që të dyja thëniet ndryshojnë kuptimisht kaq shumë, saqë vetëm ai mund t'i quajë njësoj që nuk njeh gjuhën arabe. Fjalët "*bakhsbaesh ger*" dhe

"*davar*" nuk kanë as një të njëzetën e kuptimeve të fjalëve *Rahman* dhe *Rahim* (siç do të lexoni në komentim të kësaj sureje në vazhdim), ndonëse nuk e mohoj bukurinë e kësaj thënieje. Islami pohon që të gjithë popujt e mëparshëm kanë pasur ndonjë profet. Sa qartë e thotë këtë:

وَإِن مِّنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ

"Në çdo popull ka ardhur alarmues".

(Fatir 35:25)

Pas këtij fakti, nëse do të gjeni ndonjë thënie të bukur në librat e fesë së Zarathustrës, përse mund t'u vijë keq muslimanëve? Vetëm Revrend Verit dhe bashkëfetarëve të tij mund t'u vijë keq, të cilët e kanë bërë monopol bekimin e Zotit të Madhërishëm dhe thanë se nuk ka asnjë shenjë profetësie apo shpalljeje, jashtë gjirit të bijve të Izraelit! Kurse nga këndvështrimi i Islamit, Zarathustra është profet i Zotit dhe si i tillë, ne atij i bëjmë plot nderime, sepse burimi i fjalës së tij është i njëjti me Kuranin. Andaj, ngjashmëria dhe përputhja midis dyve, nuk janë aspak të çuditshme.

(Marrë nga "Tefsir-e-Kebir", vëll. 1, f. 12-17)

Falja është në dorën e Zotit

Hazret Xhundubi^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut, Profeti Muhammed^{savs} tha:

Një njeri tha:

– Pasha Zotin! Zoti nuk do ta falë filanin!

Zoti i Madhërishëm tha:

– Kush je ti që më kushtëzon Mua që të mos e fal filanin. E kam falur atë, kurse ty të kam zhvlerësuar veprën.

*(Sahibul-Muslim, Kitab “El-Birr ves-silah vel-adab”, bab
“en-nehju an taknitil-insani min rahmetil-lahi teala”,*

hadithi nr. 6350)

Address at
CANADIAN
Parliament



AIMADRYVA
MUSLIM JAMA'AT
Canada



**Lideri musliman: OKB të
luajë rolin e saj pa u ndikuar
nga politika, padrejtësia dhe
favorizimi**

Raport mbi fjalimin historik të Udhëheqësit të Xhematit Musliman Ahmedia në Parlamentin e Kanadasë

- Udhëheqësi i Xhematit Musliman Ahmedia mbajti fjalim historik në Parlamentin e Kanadasë
- Udhëheqësi i Xhematit Musliman Ahmedia, Hazret Mirza Masrur Ahmed bëri thirrje për barazinë dhe drejtësinë.
- Ai u mirëprit nga Kryeministri i Kanadasë z. Justin Trudeau dhe dhjetëra ministra, senatorë, deputetë të tjerë.
- Shenjtëria e tij i dha “Çmimin Sir Zafrullah Khan për shërbimin publik” zonjës Louise Arbour.

Më 17 tetor 2016, Kalifi i Pestë, Udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia, Hazret Mirza Masrur Ahmed u mirëprit në Parlamentin Kombëtar të Kanadasë nga Kryeministri z. Justin Trudeau, ministra të tjerë të kabinetit dhe më shumë se 50 deputetë dhe senatorë të tjerë.

Gjatë pasdites, Shenjtëria e tij mbajti fjalim mbi temën

“Vlerat njerëzore, baza e një bote paqësore”

në sallën “Sir John A. Macdonald”, të Parlamentit, në Ottawa. Në audiencë ishin më shumë se 225 veta, duke përfshirë ministra të ndryshëm, mbi 50 deputetë, diplomatë dhe ambasadorë të 11 shteteve të ndryshme, përfaqësues të medias, akademikë, liderë të OJQ-ve të ndryshme, liderë fetarë dhe figura të shquara nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë.

Në fjalën e tij kryesore, Hazret Mirza Masrur Ahmed iu adresua çështjeve me rëndësi globale,



duke përfshirë rrezikun e një lufte botërore, lirinë fetare, radikalizmin dhe ekstremizmin gjithnjë në rritje dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Shenjtëria e tij u bëri thirrje qeverive të botës që të bëjnë drejtësinë dhe barazinë e vërtetë në të gjitha çështjet. Ai gjithashtu paraqiti mësimet islame që u japin zgjidhje problemeve të sotme që ka bota.

Duke folur për nevojën e bashkimit në shoqëri, Hazret Mirza Masrur

Ahmed tha:

“Pavarësisht nga dallimet e formimeve kulturore që u përkasim, unë besoj se këtu jemi mbledhur mbi bazën e humanizmit, andaj ka nevojë të bashkohemi. Të gjithë njerëzit dhe të gjitha organizatat bashkërisht duhet të angazhohemi për të përkrahur vlerat njerëzore dhe të bëjmë përpjekje maksimale për ta bërë botën ku jetojmë, një vend shumë më të mirë dhe më paqësor”.



Kalifi i Xhematit Musliman Ahmedia, duke udhëbequr namazin në ambientet e Parlamentit të Kanadasë

Hazret Mirza Masrur Ahmed vjoi:

“Nëse vlerat dhe të drejtat njerëzore nuk do të përkrahen në një shtet apo rajon, kjo do të ketë një efekt të zinxhiritë mbi pjesët e tjera të botës dhe keqërije të tjera të mund të përhapen më gjerë. Anasjelltas, nëse diku në botë ka mirësi, humanizëm dhe mirëqenie, ato do të ndikojnë pozitivisht edhe në shoqëri dhe te njerëzit e tjerë”.

Duke folur mbi konfliktin në rritje në botë, Hazret Mirza Masrur Ahmed tha:

“Për shkak të formave moderne të komunikacionit dhe të transportit, ne të gjithë jemi afruar shumë dhe nuk jemi më të ndarë me kufijtë gjeografikë. Megjithatë, ka një paradoks të çuditshëm dhe tragjik që pavarësisht se jemi shumë më të lidhur se kurrë, në të vërtetë po largohemi çdo ditë nga njëri-tjetri. Është shumë për të ardhur keq dhe është shumë e dhimbshme që bota ka shpenzuar më shumë për të përhapur urrejtje, dhunë dhe padrejtësi, në vend që të bashkonte njerëzimin dhe të përhapte dashuri mes tyre”.



*Kalifi i Xhematit Musliman Ahmedia Hazret Mirza Masrur Ahmed
me Kryeministrin e Kanadasë z. Justin Trudeau*

Shenjtëria e tij pranoi që frika ndaj Islamit është rritur në shumë vende të botës. Megjithatë, ai tha se frika ndaj fesë ishte tërësisht e panevojshme.

Hazret Mirza Masrur Ahmed tha:

“Më lejoni t’ju siguroj edhe një herë që Islami nuk është ai që ju zakonisht e shikoni ose dëgjoni siç portretizohet nga media. Sa u përket njohurive të mia rreth Islamit, unë di vetëm atë Islam,

i cili bazohet në emërtimin e tij. Kuptimi i fjalës islam është paqe, dashuri dhe harmoni dhe të gjitha mësimet e tij janë të bazuara mbi këto vlera fisnike”.

Hazret Mirza Masrur Ahmed vijoi:

“Fatkeqësisht, nuk mund të mohohet se ka disa grupe muslimanësh, besimet dhe veprat e të cilëve janë tërësisht kundër mësimëve të Islamit. Në shkëlqje të plotë të mësimëve themelore të



*Kalifi i Xbematit Musliman Ahmedia Hazret Mirza Masrur Ahmed
gjatë takimit me ministrat e Kabinetit të Kryeministrit të Kanadasë*

Islamit, ata po bëjnë terrorizëm dhe dhunë të tmerrshme në emër të Islamit”.

Shenjtëria e tij tha se liria fetare universale është parakusht për çdo shoqëri të suksesshme dhe tolerante.

Hazret Mirza Masrur Ahmed tha:

“Kurani i Shenjtë pohon kategorikisht në vargun 257 të kapitullit 2, që ‘nuk ka imponim në fe’. Sa e qartë dhe e plotë është kjo deklaratë, që mbron lirinë e mendimit, lirinë e fesë dhe lirinë e ndërgjegjes! Andaj, besimi dhe mësimi im është që çdo njeri në cilindo fshat, qytet a shtet jeton,

gëzon të drejtën e padiskutueshme për të zgjedhur dhe për të praktikuar fenë që dëshiron”.

Shenjtëria e tij tha se është për të ardhur keq që qeveritë e vendeve islamike dhe gjithashtu edhe disa qeveri perëndimore janë përpjekur për të kufizuar të drejtat e fesë për disa komunitete që jetojnë në shtetet e tyre.

Shenjtëria e tij tha se çdo përpjekje për të frenuar lirinë fetare është e rrezikshme.

Hazret Mirza Masrur Ahmed tha:

“Çdo individ ka të drejtën që të predikojë e të përhapë mësimet e tij



Kalifi i Xhematit Musliman Ahmedia Hazret Mirza Masrur Ahmed duke mbajtur fjalim në Parlamentin e Kanadasë

me mjete paqësore. Këto liri duhen garantuar si të drejta themelore të njeriut, andaj, bashkitë ose qeveritë nuk duhet të ndërhyjnë padrejtësisht në çështje të tilla”.

Hazret Mirza Masrur Ahmed vijoi: “Nuk është e urtë për një qeveri a parlament të vendosë kufizime mbi praktikat ose besimet themelore fetare të njerëzve. Për shembull, qeveritë nuk duhet të shqetësojnë veten se çfarë veshje duhet ta veshë një grua. Ato nuk duhet të lëshojnë dekrete duke përshkruar se si duhet të ngjajë një faltore. Nëse ato e tejkalojnë kufirin në këtë mënyrë, do të shkaktojnë shqetësim dhe frustrim te populli i tyre. Ankesa të tilla vijnë të acarohen, nëse lihen pa trajtuar dhe përfundimisht cenojnë paqen e shoqërisë”.

Duke folur për rolin e qeverisë në bazë të mësimëve të Islamit, Hazret Mirza Masrur Ahmed tha:

“Është detyrë e qeverisë dhe e deputetëve, si kujdestarë të vendit të tyre, që të qeverisin për t’u dhënë të drejtat qytetarëve, e jo për t’ua marrë”.

Shenjtëria e tij tha se edhe pse liria fetare është një parim me rëndësi vitale, por kudo që shfaqet rreziku i ekstremizmit ose nxitjes së urrejtjes, është detyra e qeverive që të ndërhyjnë dhe të marrin masa të forta për të mbrojtur popullin e tyre.

Shenjtëria e tij gjithashtu foli për nevojën e vendosjes së drejtësisë, si në çështjet e brendshme, ashtu edhe në ato ndërkombëtare.



Hazret Mirza Masrur Ahmed tha:

“Që të marrësh çelësat e qeverisë është një përgjegjësi madhore, për këtë arsye, shpesh shohim që krerët e shteteve bëjnë betime për t'i shërbyer vendit të tyre me besnikëri dhe drejtësi absolute. Me keqardhje, në shumicën e rasteve, betimet e tilla të nderuara, provohen si fjalë boshe”.

Hazret Mirza Masrur Ahmed vijoi:

“Në disa vende ka diktatorë ose qeveri të padrejta, megjithatë, superfuqitë rrinë symbyllur ndaj dhunës së tyre, sepse ato qeveri i ndihmojnë dhe ua përmbushin interesat. Dhe ka edhe vende ku

liderët ose qeveritë e tyre nuk u nënshtrohen superfuqive, andaj, këta të fundit mbështesin elemente rebele ose kërkojnë ndryshimin e regjimit. E vërteta është që nuk duket asnjë dallim në mënyrën e qeverisjes në vende të tilla. I vetmi dallim është që disa shtete bashkëpunojnë me superfuqitë, dhe disa të tjera jo”.

Shenjtëria e tij kritikoi disa qeveri që u shesin armë disa vendeve islamike, “pa marrë në konsideratë pasojat e mundshme”.

Ai tha se armët e tilla shpesh përfundojnë në duart e gabuara dhe përdoren për të vrarë qytetarë të pafajshëm.

Duke cituar luftën e Arabisë Saudite kundër Jemenit si një shembull kryesor të padrejtësisë dhe duke hedhur dritë mbi pasojat e saj të mëdha, Hazret Mirza Masrur Ahmed tha:

“Është e njohur që armët që po përdor Arabia Saudite në luftën kundër Jemenit, i ka blerë nga Perëndimi, në një luftë ku po vriten mijëra njerëz civilë të pafajshëm, duke përfshirë gratë dhe fëmijët dhe ku po bëhet shkatërrim masiv. Cili do të jetë rezultati përfundimtar i një tregtie të tillë të armëve? Banorët e Jemenit, të cilëve po u shkatërrohet jeta dhe e ardhmja, jo vetëm që do të kenë urrejtje për Arabinë Saudite dhe do të hakmerren me të, por do të kenë urrejtje edhe për furnizuesit e armëve të Arabisë Saudite dhe për Perëndimin në përgjithësi”.

Hazret Mirza Masrur Ahmed vijoi:


“Të mbetur pa shpresë dhe pa perspektivë për të ardhmen, duke dëshmuar brutalitetin më të tmerrshëm, rinia e tyre do të priret nga radikalizmi dhe, në këtë

mënyrë, do të fillojë një cikël i egër i terrorizmit dhe ekstremizmit. A vlejnë pasoja të tilla rrënuese e shkatërruese për pak miliardë dollarë?!

Shenjtëria e tij tha se institucionet ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, kanë nevojë të sigurojnë paanësinë dhe barazinë midis shteteve anëtare.

Hazret Mirza Masrur Ahmed tha:

“Superfuqitë dhe institucionet ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, në çdo rrethanë, po të kishin vepruar me të vërtetë në bazë të parimeve të tyre themelore, nuk do të kishim parë flamën e terrorizmit që po infekton pjesë kaq të shumta të botës. Paqja dhe siguria e botës nuk do shkatërrohej dhe çrënjosej në mënyrë të përsëritur. Dhe sigurisht, nuk do të kishim dëshmuar krizën kaq të madhe të refugjatëve, që sot po e huton dhe e frikëson Evropën dhe vende të tjera të zhvilluara”.



Hazret Mirza Masrur Ahmed vijoi:

“Organizata e Kombeve të Bashkuara duhet të luajë rolin e saj në vendosjen e paqes në botë, pa u ndikuar nga politika, padrejtësia dhe favorizimi”.

Duke përfunduar fjalën e tij, Hazret Mirza Masrur Ahmed tha:

“Shpresoj dhe lutem, që Allahu i Madhërishëm i mundësoftë Organizatës së Kombeve të Bashkuara si dhe qeverive të botës të veprojnë në atë mënyrë, që të

mund të vendoset paqja e vërtetë dhe afatgjatë. Alternativa tjetër nuk mund të imagjinohet, sepse në qoftë se do të vijojmë siç jemi, bota vrapon çmendurisht drejt një katastrofe të madhe, në formë të një lufte tjetër botërore”.

Hazret Mirza Masrur Ahmed shtoi:

“Zoti u dhëntë urtësi liderëve dhe politikëbërësve të botës, në mënyrë që bota që do ta lëmë pas për fëmijët tanë dhe për brezat e ardhshëm, të jetë ajo e paqes dhe e barazisë”.

Gjatë këtij eventi, Shenjtëria e tij, Hazret Mirza Masrur Ahmed i dha çmimin “Sir Zafrullah Khan për shërbimin publik” znj. Louise Arbour, ish-Komisionere e Lartë për të drejtat e njeriut në Kombet e Bashkuara dhe ish-gjykatëse e Gjykatës Supreme të Kanadasë. Çmimi iu dha duke njohur shërbimet e saj të jashtëzakonshme në sektorin publik, gjatë karrierës së saj të gjatë e të shquar.

duke ulidhur me Sir Zafrullah Khanin, sepse ai ishte gjykatësi kryesor dhe president i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. ... Unë gjithmonë kam qenë thellësisht e mbresuar duke parë se si Xhemati Musliman Ahmedia qëndron në pararojë të promovimit të kulturës së paqes dhe vijon të qëndrojë ashtu”.

Një sërë miqsh gjithashtu morën fjalën.



Duke e pranuar çmimin, znj. Louise Arbour tha:

“Jam thellësisht e nderuar duke e pranuar këtë çmim prestigjioz, që është emërtuar mbi juristin, avokatin, gjyqtarin dhe diplomatën e shquar dhe madhor. Jam veçanërisht e nderuar

Ministri i Shkencës z. Kirsty Duncan, tha:

“Është një nder dhe privilegj për të qenë këtu sonte në Parliament Hill, për të mirëpritur Shenjtërinë e tij Hazret Mirza Masrur Ahmed, Kalifin e Pestë dhe udhëheqësin e

Xhematit Musliman Ahmedia. I gjithë Parliament Hill është bashkuar sot me Shenjtërinë e tij, për të festuar me Xhematin Musliman Ahmedia dhe për të treguar mbështetjen tonë të fortë. ... Xhemati Musliman Ahmedia është shumë i dalluar këtu në Kanada dhe gjithmonë ka treguar 'dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd'".

Dr. James J. Zogby, zëvendëskryetar i Komisionit të Shteteve të Bashkuara

i nderuar të jem me ju sonte. Ajo që gjithmonë na bën përshtypje është se si Xhemati Musliman Ahmedia mbetet një kampion për të drejtat e të tjerëve që persekutohen, pavarësisht se jeni viktimë e shpeshtë e persekutimeve. Në një botë ku jotoleranca po rritet, Xhemati Musliman Ahmedia mbetet i fortë për të mbështetur tolerancën dhe dashamirësinë".



për Lirinë Fetare Ndërkombëtare tha:

"Shenjtëria juaj Hazret Mirza Masrur Ahmed, si përfaqësues i Komisionit të Shteteve të Bashkuara për Lirinë Fetare Ndërkombëtare, jam

Gjatë ditës, Shenjtëria e tij bëri takime me ministra të ndryshëm federalë të Qeverisë së Kanadasë, senatorë dhe deputetë të tjerë. Ai gjithashtu bëri takim me Kryeministrin z. Justin Trudeau.



Udhëheqësi i Xhematit Musliman Ahmedia u prit zyrtarisht nga Kryetari i Parlamentit gjatë një seance të pyetjeve, në të cilën të gjithë deputetët e pranishëm, duke përfshirë Kryeministrin, i dhanë Shenjtërisë së tij ovacion në këmbë.

Më pas, deputetja znj. Judy Sgro lexoi deklaratën e anëtarëve në Dhomën e Përfaqësuesve, që pohon:


“Z. Kryetar! Sot paradite udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia mbërriti në Ottawa për një vizitë zyrtare në *Parliament Hill*.

Gjatë qëndrimit të tij me ne, ai do të takojë ministra të kabinetit, senatorë, deputetë të ndryshëm dhe kryeministrin, në përpjekje për të nënvizuar mesazhin e tij paqësor, dashuri për të gjithë dhe urrejtje për askënd.

Kjo punë është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të Shenjtërisë së tij, për të nxjerrë në pah bukurinë dhe natyrën paqësore të besimit (Islamit) dhe për t’u bërë thirrje superfuqive që të çojnë përpara një agjendë për paqen, lirinë fetare dhe avancimin e të drejtave të njeriut në Kanada dhe në mbarë botën.

Unë përgëzoj Shenjtërinë e tij dhe anëtarët mbarëbotëror të Xhematit Ahmedia për punën e tyre, dhe zgjas dorën e miqësisë në emër të zgjedhësve të mi dhe të popullit të Kanadasë”.

Kjo ceremoni e veçantë u mbyll me një lutje, të drejtuar nga Hazret Mirza Masrur Ahmed. Pas darkës, deputetët dhe miq të tjerë të pranishëm patën mundësi ta takonin personalisht Shenjtërinë e tij.



“Unë, në dashtë Zoti,
gjithmonë do të vijoj
të përmbush detyrat
dhe përgjegjësitë e mia
për të promovuar
paqen, tolerancën,
drejtësinë dhe dashurinë,
deri në skajet e botës”.

Hazret Mirza Masrur Ahmed,
Udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia

(Revista “The Review of Religions” maj 2013, f. 69)

Le të harrohet o miq mendimi mbi **xhihadin!**

Hazret Mirza Ghulam Ahmedi, Mesih i Premtuar, Imam Mehdi^{as}

[Hazret Mirza Ghulam Ahmedi, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi, para 125 vitesh u kishte bërë thirrje gjithë muslimanëve që të hiqnin dorë nga mendimi i xhihadit me armë, pasi nuk është më kohë e luftës në emër të besimit. Por mjerisht ai u kundërshtua pikërisht nga të ashtuquajturit dijetarë muslimanë, të cilët e shpallën “qafir”. Në këtë padrejtësi nuk qëndruan mbrapa edhe hoxhallarë të famshëm shqiptarë. Duke shpresuar se këta të fundit mbase do të reflektojnë, këtu paraqesim disa vargje të poezisë së Mesihut të Premtuar^{as}, të shkruar në vitin 1902, në të cilën ai u bën thirrje të heqin dorë nga xhihadi me armë! Gjithashtu, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} bëri një profeci në këtë poezi për dështimin e rëndë të mohuesve të këtij urdhri, gjë e cila sot është vërtetuar si drita e diellit.]

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

Le të harrohet o miq mendimi mbi xhihadin
Se luftërat e betejat tashmë kanë marrë fund për besimin.

Ta dini se ka ardhë kohë e Mesihut, Imamit të besimit
Gjakrave në emër të tij i ka ardhur mbarimi.

Tani dritë e Zotit shih po vjen prej qielli
Fetva e xhihadit kot ndër ju po vërtitet.

Armik i Zotit është ai që në këtë kohë lufton
Mohues i Profetit ai që këtë kotësi në kokë arnon

“Ai do të ndalë luftën” e keni harruar këtë profeci
Hapeni pak, a nuk gjendet në Buhari?!

Profeti i zgjedhur, kryetari i dy botëve, ka thënë
Mesihu i Premtuar luftërave do t’u japë fund.

**Çdokush që do të shkojë për luftë edhe pas këtij urdhri
Le ta dijë se do të turpërohet rëndë nga mohuesit.**

**Kjo profeci do të mbetet si shenjë mes jush
E mjaftueshme, për dikë që reflekton.**

Është shenjë e Mesihut, kuptoje, s’do shpjegim
Ai do t’ju japë fund luftërave në emër të besimit.

O popull! Nuk gëzoni më atë shikim të të Dashurit
Çirrmat dhe dënesat tuaja a thua pse nuk sjellkan efekt?!

Pse ta keni atë Shikim, gjersa s’keni zemër për të
Pasi atë ia dhuroat shejtanit e jo Zotit.

Petkun e *takvasë* copë-copë e keni grisur
Të gjitha mendimet tuaja me ndryshk veshur.

Pak burra të dëlirë që ishin, po treten në dhë
Të tjerët janë bërë mizorë dhe besëprerë.

Tashmë ju vetë e thirrët qortimin e Zotit
Vetë iu ndatë Atij Miku për shkak të ligësive tuaja.

E ç’kuptim ka tani lufta juaj me të tjerët?
“të tjerët” u bëtë vet dhe shënjestër e ndëshkimit.

Më thoni të vërtetën! A ruani amanetin ende?!
A e ndieni më dritën e besimit dhe njohjen e Zotit?!

O popull! Merruni pra me mosbesimin tuaj
Kujtojeni ajetin “Keni përgjegjësi për veten tuaj”¹

Mendimi që do të vijë një Mehdi gjakatar
Që do t’jua forcojë fenë përballë mohuesve duke i vrarë,

Është kryekëput mashtrim, o të mjerë!
Shpifje, i pabazë dhe që s’mban erë

Miq! Ai që duhej të vinte, ka ardhur
Këtë sekret, edhe dielli, edhe hëna jua ka treguar.

Nuk janë pak shenjat që keni parë
Nuk janë të vogla, as sekrete të pastra që keni dëshmuar.

Por prej tyre aspak nuk përfituat
Duke shtrembëruar kokën, këtë sofër e përbuzët.


Ndër ju, ata që duan besimin dhe besnikërinë
E kanë për detyrë të shtrojnë zemrat pa përtrim.

T’u tregojnë njerëzve se është koha e Mesihut
Tanimë xhiahadi me armë është haram dhe i shëmtuar.

Unë e kreu detyrën time o miq
Po s’kuptuat tani, do ta mësoni prej Zotit.

(Marrë nga “Ruhani Khezain” vëll. 17, “Damima Tohfa Gularvijah”,
botimi i parë më 1902, f. 77-80;
Shqipëroi nga origjinali: Samad Ghori; e redaktoi: Rexhep Hasani)

1 El-Maide 5:106.



Hazret Mirza Ghulam Ahmed^{as}
Mesih i Premtuar, Imam Mehdi
1835 - 1908


Nevoja për të kërkuar besimin dhe Xhematin e Zotit

Thënie të Hazret Imam Mehdiut,
Mesihut të Premtuar^{as}

Mars 1903

Një zotëri erdhi për herë të parë (në Kadian), të cilit Hazret Mesihu i Premtuar^{as} tha:

Shikoni, bota është vetëm për pak ditë. Askush nuk është i përjetshëm. Kjo botë dhe kjo madhështi dhe shkëlqim i saj nuk janë gjëra të



“... kur njeriu i kërkon ndihmë Allahut, duke e kujtuar vetveten të paaftë, dhe nuk shpërfill, Zoti i Madhërishëm Vetë e ndihmon atë. Një mizë është ajo që bie në ndyrësi, kurse një tjetër është ajo që Zoti e ka nderuar aq shumë, saqë e gjithë bota ha mjaltin e saj. Kjo ndodhi vetëm nga përlulja ndaj Zotit.

Andaj, është e nevojshme që njeriu në çdo çast të bëjë lutjen:

Ij-jake na'budu ve ij-jake nestein

Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë

dhe Atij t'i kërkojë ndihmë. Nëse e bën këtë, ai mund të bëhet pasqyrim i mrekullive të Zotit. Hëna kur gjendet përballë diellit, fiton dritë. Por sa më shumë që i shmanget atij, aq më shumë errësohet. E njëjta është gjendja e njeriut. Derisa ai do të mbetet te pragu i Zotit, duke kujtuar veten nevojtar të Tij, Zoti e ngre atë dhe e bekon. Por në çastin kur ai beson forcën e krahut të vetë, poshtërohet...”

Image: © Kamelia Ilieva | Shutterstock

përjetshme. Duhet që të kuptoni lëvizjen (xhematin) që ka themeluar Zoti i Madhërishëm në këtë kohë. Nëse ajo me të vërtetë është prej

Zotit, çfarë fatkeqësie do të ishte për ju nëse do të qëndroni larg saj. Koha është e brishtë. Atë që bota duhet ta kuptonte, nuk e ka kuptuar

dhe asaj që duhet t'i kushtonte vëmendje, atë e ka lënë pas shpine. Ishte e domosdoshme që njerëzit të kërkonin atë që do të vinte prej Zotit.

Shikoni se njerëzit sa shumë përpiqen për nevojat e kësaj bote dhe lodhen deri në vdekje për t'i arritur ato. Por besimi, vallë, a është një gjë kaq e pajetë, që nuk kërkon mundimin tuaj as sa të qëndroni disa ditë në një vend dhe të hulumtoni reth Islamit?!

Një i sëmurë shkon te mjeku dhe ky i fundit edhe sikur ta diagnostifikojë sëmundjen, sërish has shumë vështirësi për ta mjekuar atë. Nuk e kupton menjëherë se çfarë ilaçi t'i japë të sëmurit.

Nevoja e shpalljes (*ilham*)

Njeriu edhe kur mbërrin në një qytet, ndien nevojë për të pyetur ndonjë udhërrëfyes që të arrijë në një destinacion të caktuar. Atëherë, si mundet që vetëm dogmat e njeriut të mund ta udhëzojnë atë për të gjetur rrugën e besimit dhe pëlqimin e Zotit?! A mundet vallë, që vetëm mendja tokësore të mund të jetë e mjaftueshme? Kurrsesi. Kurrsesi. Derisa Vetë Zoti i Madhërishëm

nuk do t'ia tregojë njeriut rrugën e Tij dhe derisa Ai Vetë nuk do ta njoftojë atë për mundësitë që ia sigurojnë pëlqimin e Tij, ai nuk mund të bëjë asgjë.

Shikoni, derisa nuk bie shi nga qielli, edhe toka nuk nxjerr gjelbërimin e saj, edhe sikur farën ta ketë brenda. Madje, me kalimin e kohës, edhe uji i tokës shterohet. Atëherë, a është e mundur që toka shpirtërore të gjelbërohet e të lulëzojë, pa shiun shpirtëror? Kurrsesi. Nuk mund të bëhet asnjë gjë, përveçse me shpalljen (*ilhamin*) e Zotit.

Shikoni, shkencëtarët dhe shpikësit e mëdhenj që ka bota, për ditë zbulojnë e shpikin gjëra nga më të rejat. Shpikën telegramin, shpikën trenin dhe shënojnë arritje të tilla që mendja e njeriut befasohet. A ka ndonjë tjetër më inteligjent sesa këta (shkencëtarë)? Por po këta njerëz me mendje, janë në gjendje që kanë marrë për Zot një njeri të dobët, që lindi nga barku i një gruaje si çdo fëmijë tjetër dhe, po si ata, kaloi një jetë me probleme e vështirësi, që hante e pinte dhe bënte çdo gjë tjetër që njeriu ka nevojë dhe që u gozhdua në kryq nga duart e hebrenjve

dhe vdekjen e tij e konsiderojnë si shpëtim të tyre! Naivitet kaq i madh saqë edhe një fëmijë do të qeshte! Cila është arsyeja? Arsyeja është vetëm kjo që ata u mbështetën vetëm në mendjen tokësore dhe si një korb ranë mbi ndyrësinë.

Shikoni, kur njeriu i kërkon ndihmë Allahut, duke e kujtuar vetveten të paaftë, dhe nuk shpërfill, Zoti i Madhërishëm Vetë e ndihmon atë. Një mizë është ajo që bie në ndyrësi, kurse një tjetër është ajo që Zoti e ka nderuar aq shumë, saqë e gjithë bota ha mjaltin e saj. Kjo ndodhi vetëm nga përlulja ndaj Zotit.

Andaj, është e nevojshme që njeriu në çdo çast të bëjë lutjen:

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

Ij-jake na'budu ve ij-jake nestein

Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë

(Kurani Famëllartë 1:5)

dhe Atij t'i kërkojë ndihmë. Nëse e bën këtë, ai mund të bëhet pasqyrim i mrekullive të Zotit. Hëna kur gjendet përballë diellit, fiton dritë. Por sa më shumë që i shmanget atij,

aq më shumë errësohet. E njëjta është gjendja e njeriut. Derisa ai do të mbetet te pragu i Zotit, duke kujtuar veten nevojtar të Tij, Zoti e ngre atë dhe e bekon. Por në çastin kur ai beson forcën e krahut të vetë, poshtërohet.

Nevoja për të qëndruar pranë Imamit

Për këtë arsye Zoti ka porositur:

وَكُونُوا مَعَ الصَّادِقِينَ

Ve kunu meas-sadikin

Qëndroni me të sinqertët!

(Kurani Famëllartë 9:119)

Shoqëria ndikon, është fjalë e urtë. Prandaj, është e domosdoshme që njeriu edhe sikur të ketë dije, edhe sikur të ketë fuqi dhe madhështi, të rrijë para Imamit si një dërrasë e bardhë, që të marrë ngjyra të bukura. Rroba e bardhë merr ngjyrat qartë, kurse njeriu që mban zhulin e dijes dhe të vetvetes, nuk i merr ngjyrat siç duhet. Shoqërimi me të sinqertit (*sadik*) i jep zgjidhje njeriut dhe ai merr shenja të tilla, të cilat i dritësojnë trupin dhe i këndellin shpirtin.

(“Malfuzat” vëll. 5, f. 158-161)

Disa nga profecitë e Profetit Muhammed^{savs} për kohët tona

Dr. Mirza Sultan Ahmad



Në hadithe (thëniet e Profetit Muhammed^{savs}) ka shumë profeci rreth ndryshimeve të mëdha që do të ndodhnin në epokën e fundit. Këto profeci flasin edhe për ndryshime politike, edhe për ndryshime ekonomike, edhe për ndryshime shoqërore, po ashtu edhe për veset që do të shfaqeshin dendur në epokën e fundit. Çdo ditë që kalon, provon vërtetësinë e tyre si drita e diellit. Më poshtë, do të paraqesim shkurtimisht faktet që lidhen me vetëm disa nga këto profeci.

Do të bëhet shumë gjakderdhje

Muslimi në Sahihun e tij tregon se Hazret Ebu Hurejre^{ra} thotë:

“I Dërguari i Allahut^{savs} tha: “Kiameti nuk do të vijë derisa nuk do të bëhet “herxh” me shumicë”. “Çka është “herxh”, o i Dërguari i Allahut?” e pyetën sahabët. “Gjakderdhje”, iu përgjigj Profeti^{savs}”.¹

Buhariu në Sahihun e tij përmend që Hazret Ebu Musa^{ra} rrëfen:

“I Dërguari i Allahut^{savs} tha: Përpara kiametit do të vijë koha kur dija do të zhduket dhe do të

zbresë injoranca dhe do të bëhet shumë “herxh”, dhe “herxh” është gjakderdhje”.²

Ky parashikim është bërë 14 shekuj më parë kur, në krahasim me atë që ndodh në luftërat e sotme, luftërat bëheshin në një masë shumë të kufizuar dhe po aq e kufizuar edhe gjakderdhja. Sigurisht, dhuna dhe gjakderdhja bëhej edhe përmes shpatave, shigjetave dhe ushtarëve, megjithatë, edhe mizori më i keq i asaj kohe nuk ka pasur ndonjë armë të tillë, që mund të shkaktonte gjakderdhje si armët e sotme.

Për të ditur se sa gjakderdhje është bërë pas zhvillimit të shkencës në shekullin e kaluar, mjafton të shikoni këto të dhëna: sipas një llogaritjeje, në shekullin XX, 230 milionë njerëz janë vrarë në luftëra dhe konflikte të ndryshme. Vetëm në Luftën e Parë Botërore janë vrarë rreth 13 – 15 milionë njerëz, kurse në Luftën e Dytë Botërore thuhet se janë vrarë rreth 60 – 70 milionë njerëz.

Pas Luftës së Parë Botërore, nga 1918 – 1922, në luftën civile që u bë në Rusi, sipas një llogaritjeje, u vranë rreth 1.2 milionë njerëz.



Ky parashikim është bërë 14 shekuj më parë kur, në krahësim me atë që ndodh në luftërat e sotme, luftërat bëheshin në një masë shumë të kufizuar dhe po aq e kufizuar edhe gjakderdhja.

Në periudhën 1909 – 1916, gjatë revolucionit të Meksikës, u vranë 1 milion njerëz, kurse në luftën civile të Spanjës që u bë gjatë viteve 1936 – 1939, u vranë 600.000 njerëz. Pas Luftës së Dytë Botërore deri në fund të shekullit, u derdh gjaku i 40 milionë njerëzve.³

Sidomos në Luftën e Parë Botërore, bota për herë të parë dëshmoi shkatërrim të llahtarshëm të luftës. Winston Churchill, rreth kësaj lufte shkruan:

“Lufta e Madhe që ne e kaluam ishte krejtësisht ndryshe nga të gjitha luftërat e lashta, si në fuqinë

ndërluftuese dhe ashtu edhe në agjencitë e frikshme shkatërruese, dhe ishte krejtësisht ndryshe nga të gjitha luftërat moderne në barbarinë e skajshme me të cilën ajo u luftua”.⁴

Nuk mund të imagjinohej deri më parë një gjakderdhje me përmasa kaq të mëdha. Një arsye e saj u përmend më lart, që në kohët e vjetra nuk kanë ekzistuar armët e tilla shkatërruese që mund të vrisnin njerëz në masë. Arsyeja e dytë është që në atë kohë popullsia e botës nuk ishte kaq e madhe, që 200 milionë njerëz të mund të vriteshin brenda një shekulli. E gjithë popullsia e botës në kohën e Profetit Muhammed^{savs} ka qenë 200 ose 210 milionë njerëz. Gjithashtu, edhe rritja e popullsisë në atë kohë nuk ishte e tillë, që të mendohej se bota do të kishte kaq shumë njerëz në ndonjë kohë. Madje, sipas një studimi, nga koha e Hazret Isait (Jezusit)^{as} deri në kohën e Profetit Muhammed^{savs}, vërehet 20% rënie në popullsinë e botës.⁵

Kështu që, kur e gjithë popullsia e botës ishte 200 a 210 milionë, mendja njerëzore as nuk mund të imagjinonte

se po kaq veta të vriteshin në luftëra brenda një shekulli.

Do të shtohen ndërtesat

Buhariu në Sahihun e tij përmend një hadith, i rrëfyer nga Hazret Ebu Hurejre^{ra}, në të cilin ai sjell një sërë profecish të bëra nga Profeti Muhammed^{savs}, që bëhen fjalë për shenjat e kiametit. Njëra prej atyre shenjave është:

يتناول الناس في البنيان

“Njerëzit do të krenohen duke ndërtuar ndërtesa të larta”.⁶

I Dërguari i Allahut^{savs} thotë:

لا يقوم الساعة حتى يكثر الطيقان والبنيان

“Nuk do të vijë Ora, derisa nuk do të shtohen ndërtesat”.⁷

Pa dyshim, nuk ka nevojë për argument për të provuar se në këtë epokë deri në çfarë mase janë shtuar ndërtesat. Kjo profeci e Profetit Muhammed^{savs} është përmbushur pa lënë asnjë dyshim, edhe pse ishte bërë në një kohë, kur njeriu as nuk mund ta imagjinonte pamjen që ka bota sot, për sa u përket ndërtesave të larta.

Sipas një studimi, vetëm në vitin 2010, në botë janë shpenzuar 7.5 triliardë dollarë vetëm për ndërtim, dhe 8.5 triliardë në vitin 2015. Thuhet se në 2020, brenda një viti, bota do të shpenzojë afërisht 10.3 triliardë dollarë vetëm për ndërtim.⁸

Prirja e njeriut për të ndërtuar kulla të larta ose rrokaqiej është bërë fenomen. Deri para vitit 2000, dy prej dhjetë kullave më të larta të botës ishin kullat Petronas (Petronas Towers) të Malajzisë, që u ndërtuan në vitin 1998. Të gjitha kullat e tjera të larta, janë ndërtuar në 16 vitet e fundit. Nëse do të shikojmë vetëm Evropën, prirja për të ndërtuar kulla më të larta se 100 metra, ka filluar vetëm pas vitit 1950 dhe deri më tani, janë ndërtuar rreth 100 kulla të tilla në 30 shtete të Evropës.⁹

Barinjte do të krenohen duke ngritur ndërtesa të larta

Ibni Maxheh në Sunenin e tij përmend një hadith, i rrëfyer nga Hazret Hudhejfe Ibni Jemani^{ra}, në të cilin, janë përmendur shenja të kiametit, ku ndër të tjera, thuhet:



Në kohën e Profetit Muhammed^{savs} barinjte në asnjë mënyrë nuk kishin lidhje me ndërtesa të larta. Shumica prej tyre ishin endacakë. Por kjo profeci e bërë në atë kohë thotë se po këta endacakë, në të ardhmen, do të merren me ndërtimin e ndërtesave të larta dhe do të krenohen për këtë.

“Kur barinjte do të fillojnë të ngrenë ndërtesa të larta”.¹⁰

I Dërguari i Allahut^{savs} gjithashtu tha:

من أشراف الساعة أن ترى الرعاة رؤس الناس، وأن ترى الحفاة العراة رعاء الشاء يتباهون في البنين.

“Ndër shenjat e Orës, do të shohësh se barinjte do të bëhen udhëheqës të njerëzve dhe barinjte lakuriq e të zbathur, do të krenohen duke bërë ndërtesa të larta”.¹¹

Në kohën e Profetit Muhammed^{savs} barinjte në asnjë mënyrë nuk kishin lidhje me ndërtesa të larta. Shumica prej tyre ishin endacakë. Por kjo profeci e bërë në atë kohë thotë se po këta endacakë, në të ardhmen, do të merren me ndërtimin e ndërtesave të larta dhe do të krenohen për këtë.

Marrim vetëm shembullin e Dubait. Historikisht atje jetonin barinj. Njerëzit jetonin me bagëti, pra, deve, dele etj. Kurse sot, ajo që më së shumti e dallon Dubain, është pikërisht prania e kullave të larta.¹²

Ndërtesa më e lartë në botë që quhet “Burxh el-Khalifa” gjendet në Dubai. Për sa u përket qyteteve me numrin më të madh të kullave janë: Hong Kongu, Nju Jorku dhe Dubai, në të cilat, gjenden respektivisht 315, 242 dhe 168 kulla të tilla.

Do të dalin lumenj në Arabi

Në një hadith të Profetit Muhammed^{savs} gjejmë profecinë e lumenjve në Arabi, siç thuhet:

لا تقوم الساعة حتى تعود أرض العرب مروجاً وأنهاراً.

“Nuk do të vijë Ora, derisa toka e Arabisë nuk do të rrjedhë lumenj e nuk do të bëhet e lulëzuar”.¹³

Në kohën e Profetit Muhammed^{savs}, zona e Hixhazit në të cilën përfshihen edhe Meka e shenjtë, edhe Medina e ndritur, pjesa dërrmuese e saj ishte shkretëtirë. Nuk mund të përfytyroje ndonjë gjë të ngjashme me lumin atje. Por në kohën e sotme, me bollëkun e të ardhurave, Arabia Saudite ka ndërtuar më shumë se 200 diga, të cilat mbledhin ujin e shirave në tokë. Prej tyre, 60 diga janë në Rijad, 27 janë në Mekë, 65 në Usejr, 17 në Hail, 26 në El-Baha dhe 6 në zonën e Nexhranit. Shumë diga të tjera janë nën ndërtim. Sipas një studimi, këto depozita çdo vit mbledhin 16 miliardë fut kub ujë, kurse lumenjtë që e kanalizojnë këtë ujë nëpër vendbanime, gjatësia e tyre ka kaluar në mijëra kilometra. Me këtë sistem vaditjeje, tokat arabe që

dikur ishin shkretëtirë, sot kanë ujë dhe po lulëzojnë.¹⁴

Gratë do të bashkëpunojnë me burrat e tyre në tregti

Në një hadith të Profetit Muhammed^{savs}, përveç profecive të tjera, përmendet edhe kjo që vijon:

أن بين يدي الساعة تسليم الخاصةِ وفُشُوَ التجارة حتى تعينَ المرأةُ زوجها على التجارة، وقطع الارحام، و ظهور شهادة الزور، و كتمان شهادة الحق، و ظهور القلم.

“Përpara Orës, përshëndetja do të bëhet e përzgjedhur, tregtia do të përhapet aq shumë, saqë edhe gruaja do të bashkëpunojë me burrin e saj në tregti, do të shkëputen lidhjet farefisnore, njerëzit do të japin dëshmi të rreme, do të fshehin dëshminë e vërtetë dhe pena do të përdoret shumë”.¹⁵

Për sa i përket profecisë që thotë se tregtia do të përhapet, nuk ka nevojë për asnjë provë për ta vërtetuar përmbushjen e saj, sepse ajo u përmbush në të gjitha aspektet. Edhe pjesa e dytë e saj po përmbushet rëndëshëm nga disa dekada të fundit. Sidomos në dekadën 1980,

vihet re dukshëm që gratë filluan të bashkëpunojnë me burrat e tyre në tregti. Pikërisht në atë dekadë, rritja e çifteve që bashkëpunonin në tregti ka qenë 90%. Gjithashtu, kompanitë që kishin lulëzuar, një e treta prej tyre kanë qenë ato, që drejtonin bashkëshortët.

Në vitin 1998, sipas një sondazhi, në të cilin u pyetën 120 mijë çiftet që punonin, 22.700 ose një e pesta e tyre ishin nga ata bashkëshortë, që ishin edhe bashkëpunëtorë në tregti. Kjo prijte erdhi duke u rritur edhe pas vitit 2000.¹⁶

Do të dalin minerale

Hazret Ebu Hurejre^{ra} rrëfen: I Dërguari i Allahut^{savs} tha:

إذا ظهرت معادن في آخر الزمان ياتيكم شرار الناس-

“Kur do të dalin minerale, në epokën e fundit, do t’ju nënshtrojnë njerëzit e këqij”.¹⁷

Zbulimi i mineraleve dhe përdorimi i dendur i tyre përbëjnë një faktor kyç në zhvillimin aktual të botës. Sipas International Mineral Association, deri në korrik të vitit 2016, janë zbuluar 5160 llojet të mineraleve.¹⁸



Zbulimi i mineraleve dhe përdorimi i dendur i tyre përbëjnë një faktor kyç në zhvillimin aktual të botës. Sipas International Mineral Association, deri në korrik të vitit 2016, janë zbuluar 5160 llojet të mineraleve.

Kjo profeci është plotësuar jo vetëm në aspektin që mineralet janë zbuluar me mijëra, pra, një numër jashtëzakonisht i lartë në krahasim me kohën kur ishte bërë kjo profeci, por edhe në aspektin që edhe mineralet që kanë qenë të zbuluara prej mijëra vitesh, në ditët tona nevoja, sasia dhe shfrytëzimi i tyre janë shumë më të mëdha sesa që ishin në të kaluarën.

Marrim shembullin e hekurit. Sasia e hekurit që nxirret dhe përdoret sot në botë është 18-fish më e madhe sesa ajo që përdorej para një shekulli.

Gjatë kësaj periudhe, popullsia e botës është rritur katërfish, megjithatë, edhe sasia e hekurit për frymë është rritur katërfish.

Bakri që përdoret sot në botë, është 34-fish më shumë sesa që përdorej njëqind vite më parë. Në krahasim me sasinë e bakrit që përdorte një njeri para njëqind viteve, sot e përdor tetëfishin e saj. Gara e kërkimit të mineraleve tashmë ka kapërcyer kufijtë e dheut dhe ka hyrë në thellësitë e oqeanëve.¹⁹

Nga viti 2004, kërkimet për mineralet janë shtuar rëndshëm. Një prej arsyeve të kësaj ishte rritja ekonomike, sidomos ajo e Kinës.

Do të shtohen fëmijë të jashtëligjshëm

Një tjetër shenjë e epokës së fundit, sipas Profetit Muhammed^{savs} është shtimi i mëkateve. Ndër të tjera, në një hadith, thuhet:

“Do të shtohen fëmijët e jashtëligjshëm”.²⁰

Në kohën kur është bërë kjo profeci, fëmija i jashtëligjshëm konsiderohej si një njollë në shoqëri dhe as nuk

mund të imagjinohej që do të vinte një kohë, kur një pjesë e madhe e botës, nuk do ta quante më këtë fenomen si të keq.

Gjatë vitit 2014, vetëm në Amerikë përqindja e fëmijëve që kanë lindur nga prindërit që nuk ishin të martuar ishte 40.1%. Ky numër prej shtatë vitesh vjen duke u reduktuar, pasi në vitin 2000 përqindja e fëmijëve të tillë ka qenë 47%.²¹

Sipas të dhënave të Evropës, në Islandë, Estoni, Slloveni, Bulgari, Francë, Norvegji, Suedi, Belgjikë dhe Danimarkë fëmijët që kanë lindur nga prindërit që nuk ishin të martuar janë më shumë se 50%. Në Angli, Holandë, Portugali, Latvi, Hungari, Çeki, Austri dhe Finlandë, kjo përqindje është mes 40 dhe 50. Kurse në Spanjë, Gjermani dhe Rumani, kjo përqindje është mes 30 dhe 40.


Sipas të dhënave të grumbulluara nga Kombet e Bashkuara, në vitin 1997 në Grenlandë (Greenland) ishin 65.7% fëmijë të tillë. Në 1993, në Meksikë, shifra ka qenë 41%, kurse në Panama, në vitin 1997, fëmijët që lindën nga prindërit e pamartuar ishin 79.9%. Në fund

të shekullit të kaluar, në vendet e Amerikës Jugore, si Surinami dhe Argjentina, përqindja e fëmijëve të tillë ka qenë 50. Kurse në vendet aziatike, shifra ka qenë mjaft e ulët. Për sa u përket vendeve afrikane, Kombet e Bashkuara nuk arritën të mbledhnin mjaftueshëm të dhënat.²²

Do të përhapet homoseksualiteti

Hadithet e Profetit Muhammed^{savs} gjithashtu tregojnë se në epokën e fundit bota do të jetë e përfshirë nga shthurjet seksuale, duke përfshirë edhe homoseksualitetin.²³

Deri më tani 22 shtete të botës kanë miratuar me ligj lejimin e martesave me të njëjtën gjini. E para ka qenë Holanda, që e miratoi këtë ligj në vitin 2000, të cilën e kanë ndjekur Belgjika, Kanadaja, Spanja, Afrika e Jugut, Norvegjia, Suedia, Argjentina, Islanda, Portugalia, Danimarka, Brazili, Anglia, Franca, Zelanda e Re, Uruguai, Luksemburgu, Skocia, Finlanda dhe Irlanda. Më pas, në qershor të vitit 2015, Gjykata Supreme e Amerikës e miratoi këtë ligj për të gjitha shtetet e saj.



Deri më tani 22 shtete të botës kanë miratuar me ligj lejimin e martesave me të njëjtën gjini.

Analiza e shkurtër e mësipërme tregon shumë qartë se profecitë e Profetit Muhammed^{savs} për ditët e vona hedhin dritë të fuqishme mbi sfera të ndryshme të jetës së njeriut. Zhvillimet ekonomike, shoqërore, morale dhe politike për të cilat flasin këto profeci, nuk mund të imagjinoheshin para katërmëdhjetë shekujve. Mendja njerëzore as nuk mund të përfytyronte dot që do të bëheshin zhvillime kaq të mëdha. Kjo temë është e vazhdueshme. Çdo vit që vjen do ta provojë akoma më fuqishëm vërtetësinë e këtyre profecive.

(Marrë nga "The Al-Fazl Daily", 17 tetor 2016, Rabwah, f. 3-5.
E përkthyer: Samad Ghorri)

Bibliografia

- 1 Sahih el-Muslim, Kitab "El-Fiten ve eshratus-sa'ah", Bab "Idha tevaxhehal-muslimani bisejfehima", hadithi nr. 7257.
- 2 Sahih el-Buhari, Kitab "El-Fiten", Bab "Dhuhurul-fiten", hadithi nr. 7062.
- 3 Milton Leitenberg, Deaths in Wars and Conflicts in the 20th Century, CORNELL UNIVERSITY, PEACE STUDIES PROGRAM, OCCASIONAL PAPER #29, 3rd ed. P 18&9.
- 4 Winston Churchill, The World Crisis, botuesi Macmillan Company of Canada, f. 2.
- 5 Massimo Livi-Bacci, A Concise History of World Population, Table 1.3.
- 6 Sahih el-Buhari, Kitab "El-Fiten", hadithi nr. 7121.
- 7 Nuajm Ibni Hamad, Kitab "El-Fiten", hadithi nr. 1824.
- 8 <http://marketreportsstore.com/globalconstruction-outlook-2020/>
- 9 Joanna Pietrzak, Development of high-rise buildings in Europe in the 20th and 21st centuries.
- 10 Sunen Ibni Maxheh, Kitab "El-Fiten", Bab "Eshratus-sa'ah", hadithi nr. 4044.
- 11 Alauddin el-Mutteki el-Hindi, "Kenzul-ummal", hadithi nr. 38556.
- 12 Andrea Schulte, Dubai City Guide, Peevers, f. 19.
- 13 Alauddin el-Mutteki el-Hindi, "Kenzul-ummal", hadithi nr. 38549.
- 14 Species richness of the catchment area of Al-Baha region, Saudi Arabia By Saad HOWLADAR, Yassin AL-SODANY, Kadry ABDEL KHALIK et al. Bothalia Journal. Vol. 45, No. 5; May 2015. Sustainable Development of Agriculture and Water Resources in the Kingdom of Saudi Arabia by Khodran H. Al-Zahrani Conference of the International Journal of Arts and Sciences 1(17): 3-37, 2009.
- 15 Alauddin el-Mutteki el-Hindi, "Kenzul-ummal", hadithi nr. 38514.
- 16 Going Into Business With Your Significant Other Can Lead To A Fuller, Happier Life, by Carolene Cutrone; Katherine Marshall. Working Together-Self employed Couples. Statistical Canada Catalogue no. 75-001 XPE.
- 17 Nuajm Ibni Hamad, Kitab "El-Fiten", hadithi nr. 1732.
- 18 The New IMA List of Minerals A Work in Progress Updated: July 2016.
- 19 The Importance of Mineral Resources in a National-International Context by Jonathan G. Price. http://www.eesi.org/files/121313_price_expanded.pdf (U aksesua më 1.9.2016)
- 20 Alauddin el-Mutteki el-Hindi, "Kenzul-ummal", hadithi nr. 38495; Nuajm Ibni Hamad, Kitab "El-Fiten", hadithi nr. 1796.
- 21 Recent Declines in Nonmarital Childbearing in the United States. NCHS Data Brief, No. 162, August 2014; National Vital Statistics Reports, Volume 64, Number 12.
- 22 United Nations Demographic Yearbook: Focusing on Natality, Live births by legitimacy status, and percentillegitimate: 1990 1998.
- 23 Alauddin el-Mutteki el-Hindi, "Kenzul-ummal", hadithi nr. 38495; Nuajm Ibni Hamad, Kitab "El-Fiten", hadithi nr. 1794, 1799 dhe 1832.



Dexhalli dhe ardhja e Mesihut të Premtuar^{as}

Samad Ghori

*(Fjalim i mbajtur në Xhelsa Salanën e 9-të
të Xhematit Musliman Ahmedia të Shqipërisë, më 23 tetor, 2016)*

Ata që nuk besojnë në Zot, shpesh thonë: profecitë që tregojnë njerëzit e fesë, duke iu referuar Librave dhe profetëve të tyre, shpesh nuk janë specifike. Disa herë profecitë na i tregojnë pasi të kenë ndodhur ngjarjet, që janë profetizuar. Disa

herë profecitë nuk janë të qarta sa duhet. Disa herë ato nuk janë të botuara a të publikuara dhe disa herë ato kanë kaq shumë probabilitet për të qenë të mundshme, saqë kushdo mund t'i thoshte me intuitë.

Për shembull, gjatë një dite me vranësirë, çdokush mund të thotë se do të bjerë shi. Ose një gruaje shtatzënë, mund t'i urojmë – paçi një djalë – dhe kemi të paktën 50% shansin që urimi ynë të bëhet një parashikim i saktë.

Por, profecitë që ne do të përmendim sot janë shumë specifike. Janë bërë 14 shekuj më parë. Të gjitha ato kanë qenë të botuara para më shumë se 10 shekujve, madje shumë të përfolura midis njerëzve. Janë bërë në një kohë dhe në një vend, ku askush nuk mund të imagjinonte se si do të realizoheshin ato.

E tillë është profecia e Dexhallit, siç është përshkruar nga Profeti Muhammed^{savs}.

Ai tha se *Dexhalli është gjëma më e madhe për besimtarët*.¹

Çfarë është ky Dexhall? A ka dhënë ndonjë shenjë Profeti Muhammed^{savs}? Në cilën kohë do të shfaqej ai? Në çfarë mënyre ai do të bëjë shkatërrime? Dhe si mund të shpëtojmë prej tij?

Do të flasim për këto pyetje dhe përveç tyre, do të flasim edhe për ardhjen e Mesihut të Premtuar^{as}, sepse sipas Profetit Muhammed^{savs} Dexhalli dhe Mesihu i Premtuar^{as} do të jenë në të njëjtën kohë dhe do të jenë si helmi dhe ilaçi. Për këtë arsye, Dexhallit i thonë edhe “anti-Krisht”.

Profecitë që ne do të përmendim sot janë shumë specifike. Janë bërë 14 shekuj më parë. Të gjitha ato kanë qenë të botuara para më shumë se 10 shekujve, madje shumë të përfolura midis njerëzve. Janë bërë në një kohë dhe në një vend, ku askush nuk mund të imagjinonte se si do të realizoheshin ato.

... Përshkrimi i këtyre profecive është aq i qartë, i gjallë dhe i saktë, saqë të jep përshtypje të një piktori, i cili, me panelin e tij, paraqet atë që sheh. Pikërisht në këtë mënyrë, Hazret Profeti Muhammed^{savs} na e paraqiti me fjalë piktoreske atë që u zbulua para syve të tij.

Çfarë do të thotë Dexhall?

Dexhalli nuk është një emër i përveçëm, por një cilësi, pra e ka një kuptim. Dexhall fjalë për fjalë, do të thotë “mashtgues i madh, rrenacak, ai që fsheh të vërtetën”. Fjalorët arabë japin edhe këto kuptime të kësaj fjale:

Rrenacak dhe mashtgues shumë i madh. Shumë i pasur që zotëron thesare. Grup i madh që e mbulon botën me fuqinë e tij. Grup që mbart me vete pasuritë e tregtisë.²

Tiparet kryesore të Dexhallit siç i përshkruan Profeti Muhammed^{savs}

- Do të jetë qorr nga syri i djathtë.
- Syrin e majtë do ta ketë shumë të mprehtë.
- Në ballë do të ketë të shkruar k-f-r (qafir osve i pafe), që mund të lexojë çdo besimtar qoftë i shkolluar ose i pashkolluar.
- Do të ketë aftësi të jashtëzakonshme fizike.
- Do të bëjë gjakderdhje të mëdha.
- Do të lëvizë si re shiu.

- Do ta urdhërojë qiellin të lëshojë shi dhe tokën të nxjerrë të korra.
- Do të nxjerrë thesare edhe nga shkretëtira.
- Sasi e madhe ushqimi dhe uji do ta shoqërojnë atë.
- Do të paraqesë një ujë, i cili në të vërtetë do të jetë zjarr.
- Do të paraqesë një zjarr, i cili në të vërtetë do të jetë ujë i freskët dhe i ëmbël.
- Ai do ta pushtojë gjithë botën.
- Për ta mposhtur Dexhallin, lexoni ajetet e para të sures El-Kehf.

Tani, kemi dy rrugë për ta kuptuar këtë profeci. Ose ta marrim fjalë për fjalë dhe të presim se bota do të pushtohet nga një qenie gjigante, e cila do të ketë thujse të gjitha forcat e mbinatyrshme, sikur forcat e Zotit, por do të veprojë si “anti-Zot”, ose ta interpretojmë këtë, duke besuar se Profeti Muhammed^{savs} ka përdorur metafora. Në rastin e parë, ky tekst u ngjan përrallave të Një mijë e një netëve. Por nëse e interpretojmë, ajo merr një pamje diametralisht të kundërt, dhe që është krejt aktuale.

Mjafton të nisemi nga emërtimi i Dexhallit, që do të thotë “mashtuesin shumë i madh”. Për këtë mashtuesin e madh Profeti^{savs} thotë se ai do ta pushtojë krejt botën. Që këtu na bëhet e qartë se ai nuk është një njeri apo një qenie e vetme. Sot bota është e ndarë në nacionalitete të ndryshme dhe një njeri i vetëm, sado diktator i madh të jetë, nuk mund të bëhet pushtetar i të gjithë botës.

Pra, Dexhalli është një grup, një shoqëri, një sistem, i cili, materialisht është shumë i përparuar, por shpirtërisht po aq i verbër. Të gjitha tiparet e tij aplikohen mbi shoqërinë e sotme materialiste, që drejtohet nga superfuqitë e botës. Kush mund të mohojë se shoqëria në të cilën ne jetojmë sot:

- Është qorr nga syri i djathtë (d.m.th. e verbër shpirtërisht).

- Është shumë e mprehtë nga syri i majtë (materialisht largpamëse).
- Në ballë e ka të shkruar k-f-r (d.m.th. i pafe) dhe këtë mund ta lexojë midis nesh edhe ai që ka bërë shkollë, edhe ai që nuk ka bërë asnjë shkollë.
- Është me aftësi të jashtëzakonshme fizike (shumë e zhvilluar në teknologji).
- Po bën gjakderdhje të mëdha duke shkaktuar luftëra të përgjakshme.
- Po lëviz si re shiu, nëpërmjet mjeteve të saj të transportit.
- Ka përparuar kaq shumë në teknologji, sa që kontrollon edhe shiun, edhe tokën për të nxjerrë të korra.
- Po nxjerr thesare edhe nga shkretëtira.

Tani, kemi dy rrugë për ta kuptuar këtë profeci. Ose ta marrim fjalë për fjalë dhe të presim se bota do të pushtohet nga një qenie gjigante, e cila do të ketë thujtë të gjitha forcat e mbinatyrshme, sikur forcat e Zotit, por do të veprojë si “anti-Zot”, ose ta interpretojmë këtë, duke besuar se Profeti Muhammed^{savs} ka përdorur metafora. Në rastin e parë, ky tekst u ngjan përrallave të Një mijë e një netëve. Por nëse e interpretojmë, ajo merr një pamje diametralisht të kundërt, dhe që është krejt aktuale.

- Superfuqitë e sotme furnizohen me sasi të mëdha ushqimesh dhe parash, prej vendeve të tyre vartëse.
- Shoqëria e sotme ju paraqet një xhenet, por shpirti juaj e dëshmon se ai nuk është xhenet, por ferr i vërtetë i mosbesimit. Shoqëria e sotme ju thotë se besimi në Zot që është xheneti i vërtetë, nuk është xhenet, por është budallallëk.
- Nuk ka mbetur ndonjë vend që është i pandikuar nga kjo shoqëri mashtruese.

Këto ishin vetëm ato shenja, të cilat janë të njohura nga të gjithë dijetarët e fesë Islame. Ka edhe shumë shenja të tjera, që janë shumë interesante që, në mënyrë të habitshme ju japin pamje të mjerueshme të botës sonë.

Për shembull, në “Kitab el-Fiten” thuhet:

I Dërguari i Allahut^{savs} tha:

“Shumë popuj do t’i bashkohen Dexhallit dhe do të pohojnë: Ne patjetër do të rrimë me të, ndonëse e dimë që ai është qafir (mohues), por ne hamë bukën e tij dhe me anë të tij mbrojmë pemët tona. Andaj, kur do të bjerë ndëshkimi i Zotit të Madhërishëm, do të bjerë mbi ata të gjithë”.³

Është tamam ajo që ndodh në botën e sotme, ku vendet e vogla kanë zgjedhur padronin e tyre, duke e pandehur atë si Mesih, edhe pse ndërgjegjja e njeriut lëshon klithmat: Padrejtësi! Djallëzi!

Profeti Muhammed^{savs} tha se për t’u mbrojtur nga Dexhalli, lexoni

Themeluesi i Xbematit Musliman Ahmedia, në vitin 1892 shkruan këto fjalë:

“... a mund të provoni nga Kurani dhe hadithet se ekzistuan fitnet dhe sherret që sot nuk i shikoni dot? Mbajeni mend! Edhe sikur të vdisni duke u përpjekur për të gjetur shembuj të trazirave më të rënda sesa këto, nuk mund t’i gjeni dot nga Kurani dhe hadithet e Profetit^{savs}.

Vëllezër! Po përhapen mashtrime kaq të mëdha, që edhe babai i dexhallit tuaj të përfytyruar nuk mund t’i imagjinojë dot”.

ajetet e sures el-Kehf. Mjafton ta hapni Kuranin dhe të lexoni se çfarë është shkruar atje. Aty përmendet materializmi që do të buronte nga vendet e sotme të krishtera. Në ajetet e para të sures el-Kehf flitet për doktrinën e gabuar të krishterimit. Kurse disa prej ajeteve të fundit kësaj sureje janë:

“A menduan mohuesit që do të mund të gjejnë mbrojtës nga robërit e Mi, duke Më lënë Mua? Sigurisht, Ne kemi përgatitur xhehenemin si pritje për mohuesit. Pyeti: A t’ju tregojmë për ata që do të jenë në humbje më së shumti nga të gjithë? Janë ata që harxhuan gjithë mundin e tyre në jetën e kësaj bote, duke menduar se ata po bëjnë ndërtesa për bukuri! Këta janë që kanë mohuar ajetet e Zotit të tyre dhe takimin me Të. Andaj, veprat e tyre u janë zhvlerësuar dhe, ditën e kiametit, Ne nuk do t’u japim kurrfarë vlere”.⁴

Gomari i Dexhallit

Kjo ishte vetëm një pjesë e profecisë së Dexhallit. Profeti Muhammed^{savs} ka parashikuar edhe mjetin, përmes të cilit, Dexhalli do të shkonte

kudo nëpër botë. Profeti^{savs} thotë se Dexhalli do të vijë me një gomar, por jo të zakonshëm. Unë do të lexoj fjalët e tij dhe ju do të zbuloni gomarin e Dexhallit, dhe mos harroni se këto profeci, Profeti Muhammed^{savs} i bëri 14 shekuj më parë.

- Njerëzit do të futen në barkun e tij, përmes hyrjeve të posaçme që ai do t’i ketë anash tij.⁵
- Barku i tij do të jetë mjaft i ndriçuar dhe i pajisur me ndenjësë të rehatshme.⁶
- Gomari do të lëvizë me shpejtësi të jashtëzakonshme duke bërë edhe rrugë të gjata vetëm në disa ditë ose orë, që mjeteve kafshore do t’u duhen disa muaj për t’i bërë.⁷
- Gjatë rrugës, ai do të ketë ndalesa të rregullta. Në çdo ndalesë, do të ftojë njerëzit që të futen në të dhe të ulen para se ta rinisë udhëtimin e tij dhe gjithashtu, për çdo nisje do të njoftohen me zë të lartë.⁸
- Shkurt, ky gomar simbolik do të udhëtojë vazhdimisht nga

vendi në vend duke iu shërbyer njerëzve si një mjet i shpejtë dhe i rehatshëm i transportit.

- Ai do të ushqehet nga zjarri. Por pasagjerët që do të ulen në barkun e tij, nuk do t'i prekë zjarri me të cilin ushqehet gomari.⁹
- Kjo tregon që kabinat që do të ketë në barkun e tij, do të jenë të izoluar mirë nga zjarri.
- Ky gomar do të mund të udhëtojë edhe në det dhe do të kalojë nga një kontinent në një kontinent tjetër, duke lundruar përmes valëve të detit.¹⁰
- Dexhalli do të vijë me ushqim sa male dhe ujë sa lumenj. Kjo tregon pamjen e anijeve të mëdha vetëm të kësaj epoke, të cilat superfuqitë e botës i ngarkojnë me ushqime dhe ujëra të një sasive siç është përshkruar në hadithin e Profetit^{savs}, dhe shpesh ato ua furnizojnë atyre kombeve të varfra që i nënshtrohen vullnetit të tyre.¹¹

Sa i madh ka qenë Profeti Muhammed^{savs} që na i ka treguar profecitë kaq qartë rreth gjëmës më

të madhe të të gjitha kohërave që quhet Dexhall.

Hazret Mirza Tahir Ahmed^{ra}, Kalifi IV i Xhematit Musliman Ahmedia thotë:

*“Përshkrimi i këtyre profecive është aq i qartë, i gjallë dhe i saktë, saqë të jep përshtypje të një piktori, i cili, me panelin e tij, paraqet atë që sheh. Pikërisht në këtë mënyrë, Hazret Profeti Muhammed^{savs} na e paraqiti me fjalë piktoreske atë që u zbulua para syve të tij”.*¹²

Por kjo ishte vetëm gjysma e profecisë. Profeti Muhammed^{savs} nuk bëri vetëm paralajmërim, por na tregoi edhe rrugën e shpëtimit nga kjo gjëmë. Dhe e ka theksuar kaq shumë saqë na ka bërë të qartë se nëse ka ardhur Dexhalli, dijeni se ka ardhur edhe Mesihu i Premtuar. Por një pjesë e madhe e muslimanëve janë akoma duke pritur një Dexhall dhe një gomar që ata kanë dëgjuar në përralla. Ata nuk e njohën Dexhallin, rrjedhimisht nuk e njohën as Mesihun e Premtuar^{as}. Andaj, sot shohim se si edhe vendet islamike janë bërë vartëse të këtij

Dexhalli, aq shumë saqë janë bërë epiqendër e konflikteve më të mëdha që po dëshmojmë sot. Ky ishte edhe qëllimi i Dexhallit, që ta dobësonte fuqinë e muslimanëve.

Dexhalli dhe Mesihu do të bëjnë tavaf rreth Qabes

Kjo përmendet në një profeci të Profetit^{savs}. Buhariu sjell hadithin e tij, në të cilin Profeti^{savs} tha se e ka parë në ëndërr Mesihun, birin e Merjemes që ishte duke bërë tavaf rreth Qabes. Më pas, vijon hadithi, e ka parë edhe Dexhallin dhe edhe ai ishte duke bërë tavaf rreth Qabes.¹³

Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

“Profecia që thotë se edhe Dexhalli do të bëjë tavaf rreth Qabes dhe edhe Mesihu i Premtuar gjithashtu do të bëjë tavaf rreth Qabes tregon mjaft qartë se ky tavaf nuk është fizik. Përndryshe do të na duhet të pranojmë se Dexhalli do të arrijë të hyjë në Qabe ose ai do të bëhet musliman. Të dyja mundësitë bien ndesh me hadithet e tjera autentike. Për këtë arsye, hadithi në fjalë kërkon interpretim. Interpretimi i tij që Zoti i Madhërisëm më

ka shfaqur mua është që në ditët e vona do të krijohej një grup, që do të quhej Dexhall. Ai do të ishte kundërshtar i përbetuar i Islamit dhe, për ta asgjësuar Islamin, do të sillej si vjedhës rreth Qabes, që simbolizon qendrën e Islamit, që ta çrrënjosë ndërtesën e Islamit.

Përballë Dexhallit, edhe Mesihu i Premtuar^{as} do të bëjë tavaf rreth qendrës së Islamit, që simbolizohet nga Qabeja. Qëllimi i tavafit të Mesihut të Premtuar^{as} do të jetë që ta kapë vjedhësin e quajtur Dexhall dhe ta mbrojë Islamin nga sulmet e tij.

Gjatë natës, dihet që edhe vjedhësi sillet rreth shtëpive si vëzhgues, edhe rojtari sillet rreth tyre. Vjedhësi synon të bëjë vjedhjen dhe të shkatërrojë banorët e shtëpisë, kurse rojtari synon ta kapë vjedhësin dhe ta fusë atë në burg ndëshkues, në mënyrë që njerëzit të shpëtojnë nga ligësia e tij.

Pikërisht këtë luftim e tregon ky hadith dhe zbulon që në epokën e fundit, vjedhësi i quajtur Dexhall

do të bëjë gjithçka që të jetë e mundur për ta rrëzuar ngrehinën e Islamit. Gjithashtu, edhe Mesihu i Premtuar^{as}, nga dhembshuria ndaj Islamit, do t'i çojë britmat e tij gjer në qiell, aq sa të gjithë engjëjt do t'i bashkohen, në mënyrë që ai të fitojë në këtë betejë përfundimtare. Ai as nuk do të lodhet, as nuk do të këputet e as nuk do të plogështohet, madje do të bëjë gjithçka që të jetë e mundur për ta kapur vjedhësin. E kur përgjërimit e tij do të shkojnë deri në skajin e tejme, atëherë Zoti do t'i hedhë shikim zemrës së tij që deri në ç'masë ai u shkri për Islamin. Atëherë, ajo që nuk mund ta bëjë toka, do ta bëjë qielli, dhe fitorja që nuk mund të arrihet nga duart e njeriut, do të arrihet nga duart e engjëjve”.¹⁴

Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, në vitin 1892 shkruan këto fjalë:

“Kështu që, vëllezër! Mos i bëni keq vetvetes dhe reflektoni, sepse erdhi koha dhe trazirat e brendshme dhe të jashtme e kanë arritur kulmin. Nëse do t'i vendosni këto trazira në njëren pjatë të peshores dhe

për pjatën tjetër të saj, të kërkonti në të gjithë Kuranin dhe hadithet parashikimet për gjëma të tjera më të mëdha, as të njëmijfishin e tyre nuk mund ta gjeni dot. Atëherë, çfarë gjëme tjetër dhe çfarë dexhalli tjetër më të madh se këto po prisni pas këtyre trazirave, që sipas jush do të jenë më të rrezikshme se këto?!

A mund të provoni nga Kurani dhe hadithet se ekzistuan *fitnet* dhe sherret që sot nuk i shikoni dot? Mbajeni mend! Edhe sikur të vdisni duke u përpjekur për të gjetur shembuj të trazirave më të rënda sesa këto, nuk mund t'i gjeni dot nga Kurani dhe hadithet e Profetit^{savs}.

Vëllezër! Po përhapen mashtrime kaq të mëdha, që edhe babai i dexhallit tuaj të përfytyruar nuk mund t'i imagjinojë dot”.¹⁵

Bibliografia

- 1 Sahih el-Muslim, Kitab “El-Fiten ve eshratus-sa’ah”, Bab “Fi bekijetin min ehadithid-Dexhall”, hadithi nr. 7395
- 2 Muhamed Ibn Mendhur, “Lisanul-Arab”, zëri: de-xhe-le, vëllimi IV, botimi i tretë, shtëpia botuese “Ihja et-Turath el-Arabij”, Bejrut, Liban, 1419 h./ 1999, fq. 293-294
- 3 Nuajm Ibn Hamad El-Marvazi vdiq më 288 h., “Kitab el-Fiten”, boton: “Mektebetu et-Tevhid”, Kairo, Egjipt, 1412 h./ 1991, fq. 547, hadithi nr. 1535
- 4 El-Kehf 18: 103-106
- 5 Allama Muhammad Bakir El-Mexhlisi, “Biharul-Envar”, vëllimi XIII, botimi i parë, Kitab “Tarikhul-Huxhheh”, Bab “Alameti dhuhurihi alejhis-selam mines-sufjani ved-Dexhhal”, shtëpia botuese “Ihjaul-Kutubil-Islamijjeti”, Kum, 2010, fq. 293-338
- 6 Allama Muhammad Bakir El-Mexhlisi, “Biharul-Envar”, po aty.
- 7 Abdur-Rahman Es-Safuri, “Nuz’hetul Mexhalis ve muntekhabun-nefais”, vol. 1, f. 109, shtypshkronja “Maimanijjah”, Egjipt.
- 8 Allama Muhammad Bakir El-Mexhlisi, “Biharul-Envar”, po aty.
- 9 Allama Muhammad Bakir El-Mexhlisi, “Biharul-Envar”, po aty.
- 10 Abdurrahman es-Safuri, “Nuz’hetul-mexhalis ve muntekhabun-nefais”, vol. 1, f. 109, shtypshkronja “Maimanijjah”, Egjipt.
- 11 Imam Muhammad Bin Ismail El-Buhari 810-870, “Sahihul Buhari”, Kitab “El-Fiten, Bab “Dhikrid-Dexhhal”.
- 12 Mirza Tahir Ahmad, “Revelation, Rationality, Knowledge and Truth”, U.K., 1998, f. 610
- 13 Sahih el-Buhari, Kitab “Ehadithul-Enbijai”, hadithet 3439 dhe 3440.
- 14 “Hakikatul-vahj”, “Ruhani Khazain”, vëll. 22, fq. 323-324
- 15 “Aine kemalat-e-Islam”, Ruhani Khezain, vëll. 5, f. 52-53



Ajete të Kuranit Famëlartë paralajmërimi për kohët tona

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit



إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ۝ وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرَتْ ۝

*“Kur dielli të paloset.
Kur yjet të errësohen.”*



وَإِذَا الْجِبَالُ سُيِّرَتْ ۝

“Kur malet të lëvizen.”



وَإِذَا الْمَشَارِقُ غُطِّلَتْ ۝

*“Kur devetë me barrë dhjetëmuajshe,
të braktisen”*



وَإِذَا الْوُحُوشُ حُشِرَتْ ۝

“Kur egërsirat të grumbullohen.”



وَإِذَا الْبِحَارُ سُجِّرَتْ ۝

*“Kur detet të derdhen fort
(njërin mbi tjetrin).”*





وَإِذَا التُّفُوسُ زُوِّجَتْ ۝

“Kur njerëzit të bashkohen.”



Kombet
e bashkuara



وَإِذَا الْمَوْءَدَةُ سُئِلَتْ ۝ بِأَيِّ ذَنْبٍ قُتِلَتْ ۝

“Dhe kur foshnja-femër e varrosur për së gjalli të pyetet: për çfarë faji ishte vrarë?”



وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ ۝

“Kur librat të publikohen
dhe shpërndahen.”



وَإِذَا السَّمَاءُ كُشِطَتْ ۝

“Kur qielli të zhbisbet”.



وَإِذَا الْجَحِيمُ سُعِرَتْ ۝

“Kur xhebenemi të flakërojë”.



وَإِذَا الْجَنَّةُ أُرْفِتْ ۝

“Kur xheneti të afrohet”.

عِلِمَتْ نَفْسٌ مَّا أَحْضَرَتْ ۝

“Atëherë çdokush do të marrë vesh se
çfarë kishte sjellë”.

فَلَا أَقْسِمُ بِالْحُسْنِ ۝

“Madje betohem për ato që intrigojnë
dhe pastaj tërhiqen”.

الْجَوَارِ الْكُنَّسِ ۝

“Për varkat që fshihen në vendin e tyre
të fshehtë”.

وَ اللَّيْلِ إِذَا عَسَسَ ۝

“Për natën kur bie terri”.

وَ الصُّبْحِ إِذَا تَنَفَّسَ ۝

“Dhe për agimin kur ai fillon të marrë
frymë”.

إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ ۝

“Sigurisht, kjo është fjalë e një
të dërguari fisnik”.

ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ ۝

“që zotëron fuqi dhe pozitë të lartë te
Zoti i Fronit”.

مُطَاعٍ ثَمَّ أَمِينٍ ۝

“Shumë i bindur dhe gjithashtu
besnik”.

وَ مَا صَاحِبُكُمْ بِمَجْنُونٍ ۝

“Shoku juaj nuk është i marrë”.

وَ لَقَدْ رَأَاهُ بِالْأُفُقِ الْمُبِينِ ۝

“Ai e ka parë atë në horizontin
e qartë”.

وَ مَا هُوَ عَلَى الْعَيْبِ بِضَنِينٍ ۝

“Dhe ai nuk është koprrac në tregimin e
së padukshmes”.

وَ مَا هُوَ بِقَوْلِ شَيْطَانٍ رَّجِيمٍ ۝

“Dhe as kjo nuk është fjalë
e shejtanit të mallkuar”.

فَأَيْنَ تَذْهَبُونَ ۝

“Prandaj, nga po ia mbani?”

إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ ۝

“Vërtet, kjo është veçse një këshillë për
botët”.

لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ ۝

“Për secilin nga ju që dëshiron
të tregohet i qëndrueshëm”.

وَ مَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ۝

“Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse
me vullnetin e Allahut, Zotit të
botëve”.

(Et-Tekvir 81:1-30)

HOLOKAUSTI BËRTHAMOR

*Mjerë për çdo përqeshës, shpifës,
që grumbullon pasuri dhe e numëron,
duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!
Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në "butameh".
E kush mund të të shpjegojë ty se çfarë është "butameh"?
Ajo është zjarri i Allahut, djegës i vazhdueshëm,
që godet befasisht në zemrat.*

*Është mbyllur në kolona të zgjatura flakëruese, për t'u përdorur kundër tyre.
(El-Humazah 104:2-10)*

Për të studiuar më në detaje se si Kurani Famëlartë parashikon holokaustin bërthamor, lexoni shpjegimin e këtyre ajeteve në numrin 6 të revistës "Vërtetësia".
Atë mund ta gjeni edhe në uebfaqen www.alislam.al

Profecia e Mesihut të Premtuar^{as} për luftërat botërore

(Më poshtë, vijon shqipërimi i vargjeve të fundit të një vjershe të Mesihut të Premtuar^{as}, të cilat ai i shkroi në vitin 1905. Këto vargje dhanë një parashikim të plotë për Luftën e Parë e të Dytë Botërore. Hazret Mesihu i Premtuar^{as} kishte thënë: *“Po të mos vijë ndonjë shenjë kaq e jashtëzakonshme dhe edhe njerëzit të mos e përmirësojnë dukshëm veten e tyre, atëherë dijeni që jam gënjeshtar”*).

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

Një shenjë do të shfaqet, pas ca ditësh nga sot
Fshatra, qytete e kodrina do të marrin rrokullinë

Kaq papritmas do të kapet prej zemërimit të Zotit kjo njerëzi
Edhe një i zhveshur nuk do të mund t'i veshë pizhamet e tij

Do të lëkunden befaz prej një *tërmeti**
Bimë, njerëzi, shkëmbinjtë e oqeani

Vetëm sa një çelembyll sysh kjo tokë do të rrëkëllehet
Dhe gjaku lumë do të rrjedhë sikur çurgje uji.

Të veshurit me të bardha prej jasemini
Do të gdhijnë me të kuqe mjerimi.

Njerëzit do të humbin ndjenjat, zogjtë do të hutohen
Pëllumbat dhe bilbilat do të harrojnë së kënduari

Për çdo udhëtar do të jetë e rëndë ajo kohë e orë
Çdo rrugëtar do të humbë rrugën prej një agonie

Përrenjtë e male, bjeshkët e kodrina do të skuqen
Me gjakun e të vdekurve, sikur të ishin me verë të kuqe

Do të tundet prej frike madhëri e vegjëli
Edhe Cari të jetë në atë orë, do të jetë në mjeri

Simbol i llahtarisë do të mbetet kjo shenjë hyjnore
Qielli do të ketë ngjeshur shpatën e tij për dore

O naiv i paditur mos nxito me mohime
Mbi përmbushjen e kësaj shenje, bazohet vërtetësia ime

Kjo është shpallje e Zotit, do të ndodhë pa gabuar
Prite pak ditë, me *takva* dhe i përlulur duke qëndruar

Mosbesimi yt mos beso se do të falet
E ke borxh mbi veten, që patjetër do të lahet.

* Në shpalljen e Zotit (që më erdhi), vazhdimisht është përsëritur fjala *tërmet* dhe më është thënë se ky tërmet do t'i ngjajë kiametit. Madje duhet thënë se ky mund të jetë ai tërmet rreth të cilit flet edhe surja e Kuranit "*Kur Toka do të dridhet fort nga tërmeti i saj*". Por, unë akoma nuk mund të pohoj me bindje të plotë nëse bëhet fjalë për tërmet si fenomen. Ka mundësi që të mos jetë ndonjë tërmet i thjeshtë, por të jetë ndonjë katastrofë e madhe që sjell pamje kiameti, shembullin e të cilit ta mos ketë parë bota ndonjëherë dhe të shkatërohen tej mase edhe kafshë edhe ndërtesa. Po të mos vijë ndonjë shenjë kaq e jashtëzakonshme dhe edhe njerëzit të mos e përmirësojnë dukshëm veten e tyre, atëherë dijeni që jam gënjeshtar. Por unë vazhdimisht kam sqaruar se kjo katastrofë e madhe, të cilën Zoti i Madhërishtëm e ka quajtur tërmet, nuk vjen për shkak të dallimit fetar. Ndëshkimi nuk vjen mbi dikë vetëm sepse është hindu apo i krishterë dhe as ai nuk vjen vetëm se nuk më ka pranuar duke bërë *bejt* me mua. Gjithë këta nuk përfshihen nga ky shqetësim. Po, le të frikësohet ai që pavarësisht nga feja që i përket, është kriminel, i zhytur në mosbindje dhe imoralitet, kurvar, vrasës, vjedhës, i padrejtë, paragjykses pa të drejtë, gjuhëpërkë dhe keqsjellës. Edhe i tilli nëse pendohet, nuk do të ketë ndonjë frikë. Njerëzit nëse do të bëhen të sinqertë e të sillen mirë, ky ndëshkim mund të evitohet dhe nuk është i prerë. (Autori)

("Berahin-e-Ahmedia", vëll. 5, "Ruhani Khazain", vëll. 21, f. 151-152;
E shqipëroi nga origjinali: Samad Ghori; e redaktoi: Rexhep Hasani)

Pyetje-përgjigje

**Si e kuptoni
“Vulën e profetëve”?
Ku qëndron dallimi
në botëkuptimin tuaj
dhe të muslimanëve të
tjerë për këtë çështje?**



Ky është transkriptimi i një sesioni pyetje-përgjigjesh të mbajtur nga Hazret Mirza Tahir Ahmedi^{ra}, Kalifi IV i Mesihut të Premtuar.

Pyetësi:

Si e kuptoni “Vulën e profetëve”? Ku qëndron dallimi në botëkuptimin tuaj dhe të muslimanëve të tjerë për këtë çështje?

Kalifi:

Për sa i përket pyetjes suaj të parë, dua t’ju them se kur ne japim përgjigje me argumente, disa njerëz thonë se nuk dinë shumë. Ne këtu hasim vështirësi. Një njeri që nuk di fare për fenë e vet dhe ka besuar vetëm gjërat që i kanë thënë të tjerët dhe

ato i quan fe, është shumë e vështirë ta bindësh atë, sepse ai do të fillojë të akuzojë se nuk po i përkthen saktë shkrimet hyjnore. Për t’i ikur kësaj vështirësie, do të përpiqem t’ju shpjegoj në një mënyrë tjetër, e cila do t’ju lirojë nga vështirësia e përkthimit. Do t’ju jap një përgjigje, që do të jetë shkurt e urtë.

Për mendimin tim, nëse do të bëni një analizë të sinqertë, do të kuptoni se parimisht nuk ka aspak dallim midis pikëpamjes sonë për të

kuptuar termin *Khatemun-Nebijin* (Vulë e profetëve) dhe të pikëpamjes së dijetarëve të tjerë joahmedianë. Kemi besim 100% të përbashkët. I vetmi dallim që ekziston është në përcaktimin se a do të vijë ky apo dikush tjetër.

Përse them kështu? Sepse, të gjithë dijetarët që na akuzojnë ne, thonë se Xhemati Ahmedia ka sjellë konceptin e ardhjes së një profeti të ri, edhe pse brenda umetit, pas Profetit Muhammed^{savs}, dhe kështu, e ka prishur umetin dhe, kurorën e profetësisë (*neburvet*) së Profetit Muhammed^{savs} ia ka vënë dikujt që ishte gënjeshhtar dhe trillues, *neudhubil-lab*. Thonë se ata dhe i gjithë umeti musliman kurrsesi nuk do ta durojnë dot këtë “shkelje” dhe nuk mund ta pranojnë me asnjë çmim. Pra, kjo është akuza ose padia e hoxhallarëve kundër nesh.

Pak më parë keni thënë se pjesa dërrmuese e umetit është bërë hipokrite. Natyrisht, kjo i përfshin edhe akuzuesit në fjalë. Sepse, tani do të provoj përpara jush se ata vetë besojnë se pavarësisht se Profeti Muhammed^{savs} është *Khatemun-*

Nebijin (Vulë e profetëve), do të vijë një Mesih që do të jetë profet i Zotit dhe kushdo që do ta refuzojë atë, do të përjashtohet nga rrethi i Islamit dhe ai Mesih quhet Isai i biri i Merjemes. A është e saktë apo jo? 100% është e saktë. Të gjithë hoxhallarët apo dijetarët që thonë se nuk mund të vijë asnjë profet pas Profetit Muhammed^{savs} dhe ne na akuzojnë për shkelje, janë në një mendje për riardhjen e Isait^{as}. Pra, në njërën anë thonë se nuk do të vijë asnjë profet pas Profetit Muhammed^{savs} dhe, sipas tyre, ky është kuptimi i vërtetë i “Vulës së profetëve”, dhe në anën tjetër e përjashtojnë Isain^{as} nga ky parim. Sipas tyre, ai patjetër do të vijë edhe një herë dhe do të vijë me kurorën e Profetit Muhammed^{savs}. Kështu rezulton sepse kur vjen Isai i vjetër, atij do t’i duhet t’i kundërvihet ajetit të Kuranit i cili ka thënë për të:

وَرَسُولًا إِلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ

“Është i dërguar për bijtë e Izraelit”.

(Kurani Famëlartë 3:50)

Pra, kush do ta ngarkojë atë me përgjegjësinë e re që të ketë të drejtën për të sunduar popullin e Muhammedit^{savs}? Derisa ai nuk do të vijë me kurorën profetike të Muhammed Mustafasë^{savs}, ai nuk ka të drejtë të drejtojë umetin e tij. Kështu që, dijetarët praktikisht pranojnë dy gjëra: (1) Profetësia (*nebuwet*) nuk është e mbyllur në mënyrën siç e tregojnë ata vetë. Ata ndryshe thonë, ndryshe besojnë. Sepse thonë se nuk do të vijë asnjë profet pas Profetit Muhammed^{savs}, por e pranojnë se muslimanët do të kenë nevojë për një profet. Po të mos ekzistojë nevoja, përse do të vijë Isai^{as} si profet? Kur një njeri thotë ndonjë gjë pa lidhje, thoni se është i pamend, por, vallë, a guxonin t'i etiketoni diçka të ngjashme edhe Zotit të Madhërishëm?! Si ka mundësi që Ai ka pohuar, në njërën anë, se nuk do ketë më nevojë për ndonjë profet dhe, në anën tjetër, të sjellë një profet, që kishte mbajtur rezervë prej dy mijë vitesh? Përse e ka mbajtur, nëse nuk do të lindte nevoja? Kështu që, dijetarët muslimanë, e pranojnë edhe nevojën e ardhjes së një profeti, dhe gjithashtu, e pranojnë edhe

ardhjen e tij. Por këtu ata paraqesin një dhe të vetmin justifikim. Sipas tyre, nëse vjen ndonjë profet i ri (qoftë brenda umetit) do të thuhet “Vula e profetëve” e Muhammedit^{savs} dhe nëse vjen një i vjetër, nuk do të thuhet ajo. Kjo është zgjidhja që sipas tyre e ka zgjedhur Zoti, i cili, kur e mbylli rrugën e profetëve për të ardhmen, pavarësisht se do të ekzistonte nevoja, ka bërë strategji që paska ruajtur një profet të vjetër, të cilin do ta dërgojë edhe një herë dhe do të provojë: Ja, nuk u thye aspak “Vula e profetëve” e Muhammedit! Ky është tamam koncepti i hoxhallarëve, të cilët, në emër të Islamit, jua predikojnë juve që jeni muslimanë të pafajshëm. Kurse ne themi se kjo nuk është e drejtë. E vërteta është që ashtu siç e interpretojnë joahmedianët “Vulën e profetëve”, do të quhej e drejtë, nëse nuk do të kishte më nevojë për ndonjë profet në të ardhmen. Po të marrë fund nevoja e ardhjes së ndonjë profeti, atëherë, pa dyshim, nuk do të ketë nevojë të vijë as i vjetri, as i ri. Por nëse nuk ka marrë fund nevoja, kushdo që tenton ta mbyllë rrugën e saj, është mizor dhe

i padrejtë. Sepse, i bie që bota ka nevojë për të, dhe dikush e ka ndalur atë. A nuk është mizori e madhe t'u ndalësh ujë të eturve?! Po, nëse do të provohet që etja është shuar tërësisht nga bota, atëherë ndaleni ujin, askush nuk do t'ju pengojë. Kështu që, të dyja palët, si ahmedianët, si joahmedianët, besojnë njësoj për ardhjen e profetit. Në këtë pikë nuk ka asnjë dallim. I vetmi dallim është në përcaktimin se kush do të vijë? Sipas joahmedianëve, Zoti nuk do të bëjë profet askënd prej umetit të Muhammedit^{savs}, sepse dhuntia e profetësisë (*nebuwet*) është e ndalur, por nuk është e ndalur ardhja e profetit. Sepse, po të ndalej edhe ardhja e tij, nuk mund të vijë as Isai i vjetër. A është e qartë, apo jo? Po të ishte ndalur edhe ardhja e profetit, si do të vijë Isai^{as}?! Këtu ata thonë se është e ndalur dhuntia e profetësisë, pra, askush nuk do të caktohet si profet. Kurse ardhja e një të vjetri me pak ndryshime, sipas tyre, është e lejuar. Ky është dallimi i botëkuptimit tonë dhe të atyre për "Vulën e profetëve". Sipas nesh, mënyra siç e interpretojnë ata "Vulën e profetëve" është fyerje ndaj

Islamit, ndaj Resulullahut, Profetit Muhammed *salall-llahu alejhi ve selem* dhe ndaj Kuranit. Kurani e ka cilësuar Isain^{as} si "profet për bijtë e Izraelit". Pra, Isai^{as}, sipas Kuranit, ishte vetëm për bijtë e Izraelit. I njëjti kur do të vijë në të ardhmen dhe ju thotë:

– "O umeti i Muhammedit! Unë jam profet për të gjithë ju",

a do ta kundërshtoni Kuranin për ta pranuar atë?! Si mundet që të dy të jenë të saktë njëkohësisht? Nëse e pranoni Isain, do t'ju duhet ta mohoni ajetin e Kuranit. Nëse e pranoni Kuranin, do t'ju duhet ta mohoni Isain. Pra, Kurani nuk e lejon Isain e vjetër të marrë përgjegjësinë e profetit për umetin e Muhammedit^{savs}.

Së dyti, që është akoma më e rëndësishme, duhet të dini se kush ka qenë profeti i parë i dërguar për të gjithë botën? Pa dyshim, ishte Hazret Profeti Muhammed *salall-llahu alejhi ve selem*. Kush e kishte sjellë mesimin për të gjithë botën? Sërish, Hazret Profeti Muhammed *salall-llahu alejhi ve selem*, sepse



Zoti i Madhërishëm e urdhëroi të thoshte:

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا

“O njerëz! Unë pa dyshim jam i dërguari i Allahut për të gjithë ju”.

(Kurani Famëlartë 7:159)

A kishte bërë Hazret Musai^{as} apo dikush tjetër një deklaratë të tillë? Jo. Kështu që, sipas joahmedianëve, Zoti do ta zgjedhë për muslimanët atë profet, të cilin Zoti Vetë e ka bërë të kufizuar vetëm për bijtë e Izraelit. Tani, kur do të vijë ai përsëri, Zotit patjetër do t'i duhet t'i japë një profetësi (*nebuvet*) të re, i cili të jetë mbarëkombëtar. A nuk do ta

thyejë kjo “Vulën e profetëve”, siç e paraqesin ata?! Derisa Zoti nuk do ta bëjë Isain profet mbarëkombëtar, ai nuk ka asnjë të drejtë të ndërhyjë në çështjet e umetit të Muhammedit^{savs}. Dhe po e bëri ndërkombëtar, u provua që profetësia (*nebuvet*) e tij e vjetër nuk ishte e mjaftueshme dhe Zoti ia zgjeroi atë, duke e bërë një profet ndërkombëtar, duke e lartësuar atë edhe më shumë. A i mbetet ndonjë gjë më besimit të tyre se nuk do të vijë ndonjë profet pas Profetit Muhammed^{savs}?! Kurse besimi ynë është që Zoti i Madhërishtëm i ka dhënë të gjitha potencialet umetit të Muhammedit^{savs}, që, shërbëtorët e sinqertë të Profetit Muhammed^{savs} kanë aftësi për ta përmirësuar umetin në rast nevojash. Dhe për këtë arsye, prej shërbëtorëve të tij, Zoti zgjodhi atë që dëshoi. Por joahmedianët e refuzojnë këtë duke thënë: Jo, nuk është e saktë, sepse Zoti do të sjellë një profet të umetit të Musait^{as} për ta përmirësuar umetin e Muhammedit^{savs} dhe ky është lartësimi i Muhammedit. Ç’lartësim qenka ky?! Vjedhësit hyjnë në një shtëpi dhe banorët e saj janë të dobët dhe nuk i largojnë dot. Komshiu vjen

duke kapërcyer murin dhe i shpëton banorët nga vjedhësit, dhe banorët i thonë komshiut: Të kemi bërë nder që erdhe e na shpëtove! A është e arsyeshme kjo?! Shpëtimtari mbetet mirëbërës. Kështu që, joahmedianët, siç e kanë konceptin e “Vulës së profetëve”, e kanë cenuar edhe pozitën e Profetit Muhammed^{savs} si shpëtimtar të fundit. Burimi i fundit i bekimit është Hazret Resulullahu, Profeti Muhammed^{savs} dhe Kurani Famëlartë, dhe nuk është e mundur që një profet i vjetër të vijë pas Profetit Muhammed^{savs} për të dhënë bekime. Kurse një që përfitoi prej burimit të tij, daç si profet, daç si joprofet, ai mbetet shërbëtor i tij. Hoxhallarët, duke përhapur mësimet e Kuranit, a sjellin gjëra të reja? Përkundrazi, sjellin bekimet nga vetë Kurani, prandaj, kjo nuk është ndonjë shkelje. Edhe *evlijatë* të njëjtën gjë bëjnë. Edhe dijetarët e mëdhenj të njëjtën gjë bëjnë. Edhe *sidikët* këtë gjë e bëjnë. Kur të njëjtën gjë do ta bëjë edhe profeti i ardhur prej gjirit të umetit, si mund të quhet shkelje? Kështu që, ai që vjen brenda umetit, nuk do t’i rrëmbejë kurorën e Profetit Muhammed^{savs}, kurse ai

që vjen nga jashtë do t'i duhet të bëjë një gjë të tillë (sepse ai nuk e ka ndjekur Profetin Muhammed^{savs}).

Së treti, joahmedianët pranojnë edhe ardhjen e Imam Mehdiut. Pra, thonë se dikush mund të vijë si Imam Mehdi, por thonë se ai nuk mund të vijë si profet i Zotit. Kështu që, një grup që është shkëputur nga gjiri i ahmedianëve, që quhet "Xhemati i Lahorive", e pranojnë Imam Mehdiun, por pa e quajtur atë profet, e pranojnë Mesihun e Premtuar, por pa e cilësuar atë si profet. Sa për lahoritë, pikë së pari, kur e pranuan Mesihun e Premtuar dhe nuk e pranuan atë si profet, e kanë mohuar profecinë e Profetit Muhammed^{savs} që Mesihu i Premtuar do të vijë si profet i Zotit. Së dyti, që është për të gjithë, duhet të dini se Mehdiu nuk mund të vijë pa qenë i dërguar. Është kundër logjikës. Pyetini pak dijetarët joahmedianë, do t'ju japin përgjigjen që unë jua them tani:

Ju i pyesni: Të nderuar dijetarë, e kuptuam që Mirza Ahmed Kadiani është gënjeshtar. A do të vijë ndonjë Imam Mehdi apo jo? U lodhëm duke e pritur. Do të vijë apo s'do të

vijë? A do t'ju thonë dijetarët se nuk do të vijë?

Pyetësi:

Jo nuk do të thonë kështu, sepse edhe unë besoj se do të vijë Imami, derisa i përkas sektit që ka një besim të tillë.

Kalifi:

Çfarëdo përkatësie të keni, të gjithë janë në një mendje që Imam Mehdiu do të vijë patjetër. Madje edhe shiitët besojnë se së pari do të shfaqet Imam Mehdiu dhe pastaj do të zbresë Mesihu prej qiellit. Kështu që, kur t'i pyesni dijetarët, daç shiitë, daç sunitë, a do të vijë Imam Mehdiu, të gjithë do t'ju përgjigjen – po do të vijë.

Pyetja tjetër drejtuar dijetarëve: A do të caktoni ju se kush do të jetë Imam Mehdi? A do ta caktojë shteti iranian apo Arabia Saudite?

Pyetësi:

Jo, jo. Këto pozita jepen prej Zotit.

Kalifi:

E pra, pikërisht Zoti do ta zgjedhë Imam Mehdiun dhe do ta caktojë

atë si Imam për të gjithë muslimanët. Po pasi ta bëjë atë Imam, a nuk do t'ju obligojë ta besoni atë? Apo do t'ju lër të lirë? Pra, Zoti Vetë kur e bën Imam dikë, a mundet që t'u thotë njerëzve: "Ju jap të drejtën për ta mallkuar, për ta sharë e për ta persekutuar atë dhe nuk do t'ju kërkoj llogari për këtë"? A mund të ndodhë diçka e tillë?

Pyetësi:

Jo.

Kalifi:

Kurrsesi jo! Ai që mohon Imamin e caktuar prej Zotit, e shkëput lidhjen edhe me Profetin Muhammed^{savs}. A është e saktë kjo apo jo? E pra, pikërisht këtij i thonë profet. Më jepni ndonjë përkufizim tjetër të profetit, nëse keni! Pra, profet është ai që caktohet prej Zotit. Profet është ai që je i obliguar ta pranosh.

كُلُّ عَامِنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ ۖ وَرُسُلِهِ ۖ

"Çdokush (prej besimtarëve) besoi në Allahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij dhe në të dërguarit e Tij".

(Kurani Famëlartë 2:286)

Pra, umeti i Muhammedit^{savs} është i obliguar të pranojë çdo profet, kurse dikë që nuk është profet, nuk është i obliguar ta pranojë. A është e shkruar diku: Duhet të pranosh filan imam apo filan hoxhë?! Po Imam Mehdiu, nëse do të jesh i obliguar ta pranosh, çfarë statusi do të ketë ai?! Kështu pra, gjendja e këtyre dijetarëve është që thonë edhe po, edhe jo. Ne u themi: Po dhënkeni përkufizimin e profetit, pa e quajtur profet. Pra, kur i jepni Imam Mehdiut të gjitha atributet e profetit, çfarë ju pengon ta quani si të tillë?! Ata na thonë: "Ju po e quani profet, ne nuk e quajmë". E kuptoni tani se si sillen me ne këta dijetarë?! Për këtë vjen shembulli i atij mbreti që kishte një kalë, të cilin e donte jashtëzakonisht shumë. Mbreti ka qenë fuqiplotë, dhe mizor, njëherësh. Ai mësoi se kali iu sëmur me një sëmundje të pashërueshme. U zëmërua shumë dhe tha: –

Kush guxon të ma vrasë kalin?! Ai që më thotë se kali më ka ngordhur, do t'ia pres kokën.

Pastaj i urdhëroi mjekët: – Duhet ta shëroni patjetër! E dua kalin të gjallë.

Të gjithë i zuri frika. U mbledh edhe paria e mbretit, por mjekët u thanë: S'kemi asgjë në dorë, sepse jeta dhe vdekja është në dorën e Zotit.

Veziri u tha: – E di që jeta dhe vdekja është në dorën e Zotit, por kush prej jush dëshiron të vritet?

Ra belaja! Pasi diskutuan gjerë e gjatë dhe menduan, gjetën një zgjidhje. Thanë se do të kapim fshatarin e parë që do të hyjë në qytet dhe atij do t'i themi që ta njoftojë mbretin se kali i ka ngordhur. Por e gjithë kjo nuk kishte mbetur më e fshehtë. Lajmi ishte përhapur gjithkund. E dinte edhe fshatari që hyri i pari në qytet, ndaj, u tha: Pse po më vrisni mua të gjorin, kur nuk kam asnjë lidhje me çështjen?!

– Jo, jo – ia kthyen mjekët – nuk është kjo pyetje. Ne po të japim të zgjedhësh njëren prej dy alternativave. Do që të vritesh nga mbreti apo të vrasim ne?

Fshatari u tha: – O ju të ligj! Kurrë nuk dëshiroj të vritem nga ju. Më mirë të më vrasë mbreti.

Në fakt, fshatari ka qenë një plak i mençur. Ai shkoi te mbreti dhe i tha:

– Madhëri! Urime! Urime! Kali juaj është në gjendje shumë të mirë!

Mbreti u gëzua pa masë. – Ashtu?! U bë mirë kali im?! – e pyeti për të rikonfirmuar.

– Pa dyshim që po, Madhëri, unë sapo e kam parë atë, iu përgjigj fshatari.

Mbreti tha: Më trego pak se si ndihet dhe çfarë shenjash përmirësimi ka?

Fshatari tha: – Kur po shkoja drejt kalit, ai përpëlitej aq fort saqë edhe toka dridhej nga përplasjet e tij. Por kur iu afrova, ishte kaq i qetë, saqë nuk lëvizte më fare.

Mbreti u shqetësua paksa dhe tha – Po, më trego edhe ndonjë shenjë tjetër.

Fshatari tha: – Kur po i afrohesha kalit, ai merrte frymë kaq fort, sikur pret diçka me sharrë. Por kur iu afrova krejt, nuk bënte asnjë lloj zhurme. Po kështu, kur po i afrohesha, zemra i rrihte kaq fort sikur gjëmonte, por kur shkova pranë, nuk ndihej fare.

Ai është shumë i qetë, Madhëri!

Mbreti nuk duroi më dhe i bërtiti:
– O i poshtër! Pse nuk thua se ka ngordhur?!

– E thoni ju o Madhëri, s’e them unë
– i tha fshatari.

Pikërisht kështu sillen hoxhallarët me ne. Siç e përkufizojnë Imam Mehdiun dhe Mesihun ata, tamam flasin për një profet. Kur ne u themi se pse nuk e quani profet, ata thonë: Ju e thoni, ne nuk e themi. Kjo nuk është drejtësi. Pse frikësoheni t’ia përmendni emrin, kur në realitet ju vetë e prisni? Pse interpretoni Kuranin në një mënyrë, e cila bie ndesh me zgjidhjen që ju vetë e pranoni? Prandaj, duhet ta pranoni vendimin e Kuranit që ju kam përmendur edhe më parë, i cili thotë:

وَمَنْ يُطِعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ
عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصَّٰلِحِينَ وَالشُّهَدَاءِ
وَالصَّٰلِحِينَ وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا

**“Dhe kushdo që i bindet Allahu
dhe të dërguarit, do të jetë me ata
që Allahu i ka bekuar (domethënë),**

**ndër profetët, të vërtetët,
dëshmorët dhe të sinqertët. Sa
shoqëri e mbarë janë këta!”**

Kurani Famëlartë 4:70)

Kjo është karakteristika e umetit të Muhammedit^{savs}. Krenar do të jetë ai që gjen shoqërinë e këtij umeti. Pra, nderi për umetin e Muhammedit u cilësua në këtë mënyrë, dhe jo në atë mënyrë siç thonë joahmedianët se do të vijë profet i një umeti tjetër dhe do ta bekojë umetin e Muhammedit^{savs}. Ky është realiteti i “Vulës së profetëve” dhe kështu besojmë ne. Faleminderit.



KALIFATI I DREJTË DHE RIVENDOSJA E TIJ

Bujar Ramaj

*Fjalim i mbajtur në Xhelsa Salanën e 5-të
të Xhematit Musliman Ahmedia të Kosovës, më 29 maj 2016*

Sot në këtë botë të trazuar të mbushur me konflikte dhe sjellje ekstreme, feja jonë e bukur islame, si pasojë e imazhit të keq, krijuar nga sjelljet e disa muslimanëve që s'kanë asgjë të përbashkët me Islamin, është në ditët e saj më të vështira. Turma njerëzish me thirrjet fetare,

vrasin të tjerët dhe vriten me njëri-tjetrin, plaçkitin dhe djegin duke përmendur emrin e Zotit dhe të Profetit tonë të dashur^{savs}, sjellje këto që jo vetëm hidhërojnë Allahun dhe njollosin figurën hyjnore të Profetit tonë^{savs}, por kanë shkaktuar një përçmim dhe urrejtje në të

gjithë planetin, duke vënë në situatë të vështirë besimtarët e sinqertë, popujt e vendeve muslimane si dhe simpatizantët e fesë së drejtë. Duke mos mjaftuar kjo, dalja e disa grupeve me emrin e një kalifati të dhunshëm e ka komplikuar akoma dhe më tepër doktrinën islame, prandaj del e domosdoshme që ne si besimtarë të një xhemati të drejtë të jemi të qartë vetë dhe të bindim të tjerët se çfarë është kalifati i vërtetë.

Kurani erdhi te një popull që nuk e kishte konceptin e shtetit. Fiset beduine jetonin sipas disa rregullave dhe zakoneve të trashëguara në një ecejake dhe përplasje të egër anarkie në shkretëtirë midis njëri-tjetrit, në grupe njerëzish dhe fisesh pa një institucion drejtimi politiko-shoqëror.

Dihet që kërkesa e parë për bashkëjetesë ka lindur nga nevoja për një marrëveshje midis njerëzve për të ruajtur pasurinë dhe jetën e tyre dhe më vonë edhe për të planifikuar drejtimin dhe organizimin e tyre shpirtëror, social, politik dhe ekonomik. Por a ka një të tillë në Kurandin Famëlartë?

Në fakt, kjo është një pyetje që mua më ka ngacmuar mjaft duke e lexuar dhe rilexuar Kurandin disa herë. Ajo që kam vënë re në Kuran është se në përgjithësi ai nuk merret me detaje mbi sistemet në fushat e ndryshme. Ajo që është e veçantë në këtë libër hyjnor është se ai i trajton gjërat në evoluim, për të mos pasur asnjëherë mospërputhje në kohë dhe në hapësirë. Kështu që edhe për sistemin politik Kurani orienton se si duhet të sillen individit dhe shoqëria për të mos prishur ekuilibrin e jetës. Kurani e trajton njeriun si tulla dhe përmes saj bëhet ngjizja e cilitdo sistem qoftë ai shpirtëror, politik, shoqëror a ekonomik. Përsosja e njeriut, edukimi i tij si dhe spiritualiteti i lartë për të fituar përjetësinë, janë mesazhe kryesore në të. Prandaj Kurani merret si me elementet e thjeshta të edukimit: si hahet, si pihet, si sillet me prindërit, me gruan e fëmijët, me të afërmit e me fqinjët, të vobektit e jetimët, si bashkëjetohet me të tjerët, si trashëgohet prona, si jepet taksa a huaja, si ndalohet kamata, bixhozi, alkooli, imoraliteti, vrasja, hakmarrja e deri tek ato më të

vështirat: marrëdhëniet me Zotin, marrëdhëniet me të padukshmen, meditimi, njohja e vetvetes dhe e ligjeve të gjithësisë, parimet mbi të cilat duhet të funksionojnë bashkësitë, kuptimin e jetës, të shpirtit, të dashurisë dhe lumturisë, me qëllim për ta përsosur njeriun dhe krijimin e harmonisë së tij me gjithësinë dhe hyjnore. Progresi dhe zhvillimi i vërtetë njerëzor, theksohet në të, vjen vetëm nëpërmjet edukimit dhe përsosjes shpirtërore të njerëzve në një mjedis të drejtësisë, të barazisë, të lirisë, të së drejtës, të vëllazërisë dhe dinjitetit njerëzor. Nga ky brumë mundet të krijohet gjithçka: bashkësi fetare, shtet, institucione, shkencë, shoqëri shembullore me mirëkuptim, paqe dhe prosperitet.

Por ajo që theksohet në vazhdimësi, si kusht i domosdoshëm i një shoqërie, e që është e vetmja rrugë e shpëtimit, janë marrëdhëniet, marrëveshjet dhe besëlidhjet e individit dhe shoqërisë me Zotin, thënë me fjalë të tjera, t'i dorëzohesh Zotit. Njeriu i dorëzohet Zotit vetëm nëpërmjet *bejt*; besëlidhjes. Nëse do të lexojmë me

vëmendje Kuranin Famëlartë, do të shikojmë se vetë Allahu i Lartësuar bën shpesh betime; për qiellin, për tokën, për kohën, për njeriun, për penën, për malin e deri te pemët. Në këto betime, shpjegon Mesihu i Premtuar^{as}, ka shumë urtësi të fshehura, që mendja njerëzore e ka të vështirë ta kuptojë. Ai shkruan:

“Qëllimi i beve është që ai që bën be paraqet një dëshmi për vërtetimin e pohimit të vet. Por njeriu nuk ka asnjë dëshmitar për pohimin e vet dhe thërret Allahun për dëshmi se ai di të dukshmen e të padukshmen duke qenë dëshmitar i përhershëm”.¹

Pra *'bejt'* do të thotë t'ia dorëzosh jetën tënde Allahut. *Bejt*i është niveli më i lartë i angazhimit dhe lidhjes së njeriut me Zotin, ky ka qenë dhe akti më i lartë i Ademit^{as} që Zoti pasi e krijoi Tokën dhe e nënshtroi plotësisht për njeriun, në këtë zanafillë Zoti e zgjodhi njeriun si mëkëmbës të Tij në Tokë dhe pas *bejt*it të Ademit^{as}, Allahu i Lartësuar tha:

“Unë do të vë një mëkëmbës në Tokë”.²

E pastaj në suren en-Nur thekson:

*“Allahu u ka premtuar atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, se do t’i bëjë patjetër kalifë në Tokë, ashtu siç i ka bërë kalifë ata që ishin para tyre. Ai do t’ua përforcojë fenë e tyre, të cilën e ka pëlqyer për ta dhe do t’ua shndërrojë frikën e tyre në siguri. Ata do të më adhurojnë Mua dhe nuk do të Më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që tregohen mosmirënjohës edhe pas kësaj, pikërisht ata janë të pabindur. Mbajeni namazin, jepni zekatin dhe binduni të Dërguarit, në mënyrë që të mëshiroheni”.*³

Kjo është një nga përgjegjësitë më të mëdha që i është dhënë ndonjë qenieje, një preferencë e rrallë e Krijuesit për ndonjë qenie, pra një esencë krijimi dhe një pasqyrë e refleksit të dritës së Krijuesit, me misionin e shprehjes së vullnetit të Zotit në Tokë brenda kornizës së vullnetit të lirë të njeriut. Duke e marrë detyrën e përfaqësuesit hyjnor, Krijuesi bëri marrëveshjen e parë me njeriun, pas shkeljes së marrëveshjes në parajsë:

“Ne u thamë: “Dilni të gjithë nga këtu! Kur t’ju vijë ndonjë udhëzim prej Meje, ata që do ta ndjekin udhëzimin Tim, nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen.

*Kurse ata që do t’i mobojnë dhe do t’i quajnë gënjeshtra shenjat Tona, do të jenë banorë të zjarrit, në të cilin do të mbesin gjatë”.*⁴

Kjo thënie e Kuranit Famëlartë është njëkohësisht zanafilla e marrëveshjeve që Zoti nisi me njerëzit në Tokë. Pra Ai i dha liri njeriut të ndjekë dy rrugë: rruga e parë për ndjekësit e udhëzimeve të Tij që vijnë nëpërmjet librave hyjnorë, të quajtur besimtarë dhe rruga e dytë për ata mos ndjekësit e këtyre udhëzimeve që do të quhen jobesimtarë, ata të rebelimit ndaj vullnetit të Zotit, që do të jenë shumica:

*“...Shumica e njerëzve, sado që të dëshirosh, nuk do të besojnë”.*⁵

Pra thënia “nuk do të besojnë” shpreh të ardhmen. Kjo profeci kuranore vërtetohet më së miri Kalifatin e

fundit se ai do të jetë shpirtëror sepse do të përfshijë një pjesë të vogël të njerëzve të cilët do të jenë më të devotshmit siç është sot Kalifati i Xhematit Musliman Ahmedia.

Për ta menaxhuar sa më mirë Tokën, Krijuesi i dërgoi njeriut herë pas here udhëzime që përmbanin rregullat dhe ligjet që njerëzit duhet të zbatonin në jetën tokësore në raportet mes njëri-tjetrit dhe planetit, për mbarëvajtjen e jetës në Tokë dhe fitimin e përjetësisë. Përmbledhja e fundit e të gjithë këtyre udhëzimeve është Libri i fundit Kurani Famëlartë. Por besëlidhja më e madhe që trajtohet në Kuran është besëlidhja me popullin hebre e realizuar nëpërmjet Hazret Musait^{as}:

*“Dhe (kujtoni) kur morëm besëlidhjen tuaj dhe ngritëm Turin mbi ju (dhe thamë): “Kapeni fuqimisht atë që jua kemi dhënë dhe mbajeni mend përmbajtjen e saj, që të mund të shpëtoni (nga shkatërrimi)”.*⁶

Pra besimi është marrëveshje, qëllimi i të gjithë librave hyjnorë

është që ta përforcojnë këtë marrëveshje, këtë rregullsi, ligjësi që ruan baraspeshën. E gjithë kjo jetë është marrëveshje: jeta jonë një marrëveshje me Zotin, shteti një marrëveshje e shoqërisë, martesja një marrëveshje për jetesë, të jetuarit e të vepruarit midis njëri-tjetrit është një tërësi marrëveshjesh... dhe për mbarëvajtjen e kësaj marrëveshjeje ka shpërblime dhe sanksione. Kjo është një nga temat më të gjera në Kuran dhe një nga temat që prek në mënyrë të veçantë; mirënjohjen njerëzore, zhvendosjen e së drejtës, raportin turmë-popull-individ, sistemin diktatorial, raportin sovranitet-pasuri-pushtet-lumturi, si dhe rrugën e shpëtimit, tema të mëdha këto që janë pasqyruar në të gjitha kryeveprat botërore.

Kjo marrëveshje, kjo besëlidhje midis Zotit dhe popullit hebre, rreth 3500 vjet më parë e deri më sot, ka në thelb dhjetë porositë e famshme, të cilat kanë marrë pasaportën universale e që është kodi moral më i qëndrueshëm edhe sot. Këto porosi e udhëzime të Zotit theksohen edhe në Kuranin Famëlartë e që janë:

Thuaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka ndaluar Zoti juaj që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim) dhe (ju ka obliguar) që të silleni mirë me prindërit; që të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të frikës së varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë juve dhe ata; që të mos u afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia. Këto ju obligon Ai, me qëllim që të kuptoni. Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë moshën e pjekurisë! Kryejeni drejtë matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësisë së tij! Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj! Plotësojani besën e dhënë Allabit! Këto ju porosit Ai që të mos harroni. Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai për t’iu druajtur Atij”.

Për sistemet politike Kurani ka dhënë dy shembuj, një e Faraonit dhe një e Davudit^{as}. Kurani e quan tirani dhe diktaturë sistemin politik të Faraonit dhe vë në dukje pesë karakteristika të tij:

- Pushteti i Faraonit është absolut duke e shpallur veten zot në Tokë, ai e detyronte popullin të adhuronin vetëm atë.
- Në themel të pushtetit të Faraonit ishte padrejtësia, kthimi i njerëzve në skllëvër, keqtrajtimi, dhe mosrespektimi i të drejtave elementare njerëzore.
- Ndarja në grup, klasa, shtypja e opozitës, pakicës, deri në vrasjen e trashëgimtarëve të kundërshtarëve.
- Lakmia për pushtet, duke ua rrëmbyer të tjerëve.
- Shteti represiv policor.

Habia është se ky sistem është karakteristikë e të gjithë diktaturave, është imituar nga të gjithë diktatorët deri në ditët e sotme, sidomos në disa vende muslimane, dhe ashtu si Zoti në Kuran thotë se do ta ruante trupin e Faraonit, dhe të gjithë diktatorët

janë munduar të bëjnë të njëjtën gjë; të ndërtojnë varre gjigante ose përmendore e monumente të gdhendura. Përfundimi i të gjithë diktatorëve ka qenë tragjik. Nga ana tjetër Kurani ka dhënë dhe sistemin shpirtëror, mbretëror, mbretërinë e Davudit^{as} dhe Sulejmanit^{as}, ku karakteristika themelore e tyre ishte e kundërta e Faraonit:

- Adhurimi vetëm i Zotit pa ngritur idhuj të tjerë (sa domethënëse është kjo gjendje sot në botë).
- Gjykimi me drejtësi, sidomos respektimi i kundërshtarit.
- Thjeshtësia dhe moslakmia e pasurisë e sidomos e pasurisë së tjetrit.
- Drejtësia dhe respekti për të gjitha qeniet që nga miza e deri tek adhuruesit e diellit.
- Mospranimi i korrupsionit dhe ryshfetit nga elita udhëheqëse dhe gjyksesit e së drejtës. Zoti thotë në Kuranin Famëlartë:

“O Davud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe

tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut!”⁸

Ky ajat të jep idenë se Zoti parapëlqen sistemin shpirtëroro-mbretëror me këshillë të të urtëve, por në fakt si Davudi^{as} dhe Sulejmani^{as} ishin edhe mbretër edhe profetë, pranonin sovranitetin absolut të Zotit dhe ndiqnin drejtësinë, një drejtësi me burim hyjnor dhe jo një drejtësi të shpikur nga njerëzit. Të qenët profet, kalif dhe udhëheqës e shikojmë edhe te Musai^{as} edhe te Muhammedi^{savs}.

Ndoshta Zoti me këta shembuj ka dashur që t'i japë njerëzimit modelin e drejtimit të një bashkësie dhe të një sistemi shpirtëror dhe shoqëror të ngritur mbi drejtësinë me burim hyjnor dhe pranimin vetëm të sovranitetit të Zotit. Te historia e Musait^{as} dhe e popullit hebre, të trajtuar mjaft gjerësisht në Kuran, ka shumë mësim për drejtimin e njerëzimit, por mesazhi fort i theksuar në këtë histori është se njerëzit kur nuk udhëhiqen nga udhëzimet hyjnore, janë si turma. Ata kanë ndjesinë e rebelimit dhe të krijimit të idhujve. Interesante është se gjatë udhëheqjes së popullit

hebre, kur Musai^{as} u shkëput për të marrë udhëzimet e Zotit, populli devijoi, u rebelua, adhuroi vëcin në vend të Zotit, duke harruar mirësitë e mëdha që u bëri Zoti duke i nxjerrë nga gjendja e skllavërimit në njerëz të lirë, një fenomen ky që është përsëritur nga shumë popuj të skllavëruar që kur fitojnë liri dhe pushtet bëhen mizorë dhe të padrejtë. Historia e besëlidhjes së Musait^{as} u përsërit me Profetin Muhammed^{savs}.

“O Profet, kur të vijnë tek ti besimtarët e të betohen se nuk do t’i shoqërojnë Allahut asgjë (në adhurim), nuk do të vjedhin, nuk do të kurvërojnë, nuk do t’i vrasin fëmijët e tyre, nuk do të sjellin ndonjë shpifje të sajuar nga ato vetë dhe se nuk do të të kundërshtojnë në çfarë është e drejtë dhe e arsyeshme, atëherë ti pranoje betimin e tyre dhe lutju Allahut t’i falë. Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë”.⁹

Dhe mrekullia ndodhi, populli arab ishte një populli i egër, vrastar, pa koncept shteti dhe shoqërie, nën dritën e Profetit Muhammed^{savs} duke

bërë *bejtin* në dorën e tij, u bë popull i zgjedhur dhe më i miri i asaj epoke, për t’u udhëhequr më vonë nga katër kalifët e drejtë. Sundimi i kalifëve të drejtë (632-661) përfaqëson atë periudhë, që u quajt si epoka e artë e Islamit të vërtetë, nga brezat e mëvonshëm të muslimanëve. Ata shpesh do të përkufizonin veten dhe botëkuptimin e tyre fetar, sipas mënyrës që ata gjurmuan në ngjarjet madhështore, edhe pse të vrullshme dhe jetëshkurtra të asaj periudhe formuese. Koha e Profetit Muhammed^{savs} dhe e kalifëve të drejtë i dha famë popullit arab në mbarë planetin. Modeli i drejtësisë i ngritur nga Profeti Muhammed^{savs} që ishte i fundit dhe më i ploti, ishte një sistem shpirtëror, më i arriri dhe më shembullori, ku mbretëronte drejtësia shoqërore dhe ekonomike, liria, barazia dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut. Të gjithë ata udhëheqës pas Profetit Muhammed^{savs} që u përpoqën t’i afroreshin sa më shumë modelit të ngritur nga Profeti kishin rezultate befasuese dhe mbahen mend në historinë njerëzore.

Muslimanëve të sotshëm po i ndodhë pikërisht ajo që i ndodhi popullit të Musait^{as}. Muslimanët janë ndarë në grupe duke i bërë mizori njëri-tjetrit. Si duket parashikimi i Profetit^{savs} se ata drejtues që do të vinin pas tij do të ishin Kalifë të drejtë, më vonë mbretër despotik e në fund sundimtarë mizorë e tiran, është realizuar plotësisht. Sot, politika që bëhet në emër të Islamit ka sjellë tiraninë që po rrëqeth gjithë njerëzimin.

Sot vetëm Kalifati Ahmedia është sistemi më i lartë shpirtëror që drejton Xhematin e Profetit Muhammed^{savs} në rrugën e pastër të Islamit të vërtetë, që bëjnë *bejtin* e u qëndrojnë besnik udhëzimeve të Zotit. Ata zbatojnë praktikën e *bejtit* madhështor siç bëhej në dorën e Profetit Muhammed^{savs}. Hadithi i mëposhtëm i Profetit tonë të Shenjtë^{savs} e ka parashikuar këtë shkëlqim dhe rënie:

“I Dërguari i Allahut^{savs} ka thënë se profetësia (nebuvet) do të mbetet në mesin tuaj aq sa ka dashur Allahu që të mbetet, e pastaj Allahu i Lartësuar do ta

*ngrejë atë. Pastaj do të vendoset kalifati që vjen pas profetësisë, dhe do të mbetet aq sa do të dëshirojë Zoti dhe pastaj Zoti do ta ndërpresë atë. Pastaj ai (d.m.th. Kalifati) do të ndiqet nga një mbretëri tiranike. Ajo do të qëndrojë aq sa ka vendosur Allahu e pastaj Allahu i Lartësuar do t’i japë fund asaj. Mandej do të vendoset një tjetër mbretëri despotike, edhe kjo do të mbetet për aq kohë sa ka dashur Allahu e pastaj Allahu i Lartësuar do t’i japë fund asaj dhe pastaj do të vendoset Kalifati që vjen përmes profetësisë (nebuvet) dhe pastaj ai heshti”.*¹⁰

Pra, përfundimisht, sa më shumë që njerëzit udhëhiqen nga ligjet hyjnore aq më e drejtë është ajo bashkësi dhe jetëgjatësia e saj është e gjatë. Ndërsa sa më shumë i largohen orientimit prej ligjeve hyjnore, shoqëritë bëhen më mizore dhe më jetëshkurtra. Në Islamit e vërtetë shpirti dhe bota duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Shpirti i lirë është elementi thelbësor i fitoreve të çfarëdo sistemi. Njerëzit mund të komandohen me

armë, me urdhra dhe me dënime, por udhëheqja më e mirë është shpirti i lirë dhe devotshmëria siç na mëson Kurani. Devotshmëri do të thotë nënshtrim dhe frikë ndaj Zotit e jo ndaj njerëzve. Sovraniteti dhe pushteti i takon Zotit i cili është Sovrani Absolut. Kur njeriu ka frikë nga njeriu, atëherë ai e bën njeriun zot, sovran, duke iu nënshtruar diktatorëve, por kur njeriu e quan sovran popullin – gënjen veten, mashtrohet. Pra, pa e pranuar sovranitetin e Zotit nuk ka sovranitet tjetër. Të gjithë të barabartë para Zotit, të gjithë të adhurojnë të njëjtin Zot, të gjithë të zbatojnë udhëzimet e Tij, të shpiejnë në lirinë e shpirtit, në prosperitet dhe sukses të padiskutueshëm.

Përfundimisht, Kurani udhëzon se pa e krijuar sundimin shpirtëror nuk mund ta ndërtosh sistemin politiko-ekonomik. Kjo jep kuptimin se çdo bashkim i besimtarëve në Kalifat është spiritual për të ndihmuar në përparimin cilësor të një sistemi politik.

Një shekull më parë, Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu,

Hazret Mirza Ghulam Ahmedi^{as}, me mesazhe nga Allahu xh.sh. dhe brenda profecisë së Muhammedit^{savs}, rilindi Islamit, e pastroi atë nga teprimet e devijimet duke rivendosur Islamit e vërtetë ashtu siç ishte i pastër në kohën e Profetit Muhammed^{savs} dhe katër kalifëve të drejtë. Ai rivendosi Kalifatin e drejtë që do të vazhdojë deri në Ditën e Kiametit. Ishin pikërisht ato betime të ngashëruara të ahmedianëve të parë që duke bërë *bejtin* në dorën e Mesihut të Premtuar^{as} ngritën themelin e ngrehinës së ndritur të Kalifatit që sot është më i fortë se kurrë.

Tashmë kalifati i Profetit Muhammed^{savs} do të rrjedhë nëpërmjet shërbëtorit të tij të sinqertë dhe vulës së kalifëve. Prandaj, jemi fatlumë sepse bëjmë pjesë ndër ata që gëzuan këtë sihariq të Profetit Muhammed^{savs}. Duke sqaruar ajetin e sures el-Xhuma që thotë:

“Ai do t’ua dërgojë edhe të tjerëve që ende nuk u janë bashkuar...”¹¹

Kalifi i Pestë (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) thekson:

*“Profeti Muhammed^{kas} i bashkoi të parët me të fundit. Jemi fatlumë që Zoti na bëri të jemi pjesë pikërisht në këtë grup. Jemi fatlumë që Zoti na bëri ta pranojmë atë të dashur të Profetit Muhammed^{kas}, për të cilin ai (savs) kishte thënë se do ta sillte besimin edhe një herë nga ylli thurej-ja e ta rivendoste në Tokë. Allahu i Madhërishtëm na dha mundësi t’ia përcjellim selamin atij Imam Mehdiu, për të cilin na porositi Profeti Muhammed^{kas}. Përveç kësaj, Allahu i Madhërishtëm na dha mundësi ne ahmedianëve bejtërës të bëjmë edhe bejtin e Kalifatit që u nis pas Mesihut të Premtuar^{as}”.*¹²

Hazret Mirza Ghulam Ahmed^{as}, Mesih dhe Mehdi, e ka përshkruar Kalifatit si shfaqjen e dytë të fuqisë së Zotit – meqë ardhja e profetëve është shfaqja e parë e fuqisë së Tij. Ai nxjerr një ngjashmëri dhe pohon që shembulli i Kalifatit të Ebu Bekrit ra ishte shfaqja e dytë

e fuqisë së Zotit. Ai citon ajetin 56 të sures en-Nur dhe paralajmëron duke shkruar:

*“Por ajo fuqi e dytë nuk mund të ndodhë para se unë të largohem. Pasi unë të kem shkuar, atëherë Allahu do t’jua dërgojë juve fuqinë e dytë të madhështisë së Tij, që do të mbetet përgjithmonë me ju”.*¹³

Kjo fuqi e dytë padyshim i referohet Kalifatit Ahmedia. Kalifati në Xhematin Musliman Ahmedia hedh poshtë kategorikisht përdorimin e çfarëdo dhune në çështjet fetare, ndërsa ka ndërmarrë një xhihad intelektual me anë të penës, përmes të cilit, ai po përhap botërisht mesazhin paqësor të Islamit dhe u jep përgjigje akuzave të ngritura ndaj Islamit. Kur përballet me përndjekje dhe persekutim, ai i përmbahet durimit, këmbënguljes dhe qëndrueshmërisë. Kur vihet në shënjestër të urrejtjes, trysnisë dhe intolerancës, ai përhap paqen dhe tolerancën. Ai përkrah kauzën e të papërkrahurve dhe është angazhuar në ngritjen dinjitoze të të shtypurve të nëpërkëmbur.

Pikërisht në librin “Testamenti”, ku Hazret Imam Mehdiu dhe Mesihu i Premtuar^{as} bëri profecinë e vendosjes së Kalifatit në Xhemat, duke iu drejtuar anëtarëve të Xhematit, thotë:

“Mos mendoni se Zoti do t’ju lërë të prisheni. Ju jeni një farë që është mbjellë nga dora e Zotit në Tokë. Zoti thotë se kjo farë do të shtohet, do të lulëzojë dhe nga çdo anë do të dalin degët e saj dhe do të bëhet një pemë e madhe. I bekuar është ai që beson fjalën e Zotit dhe nuk frikësohet nga sprovat që has në mes. Sepse edhe sprovat janë të domosdoshme, në mënyrë që Zoti t’ju sprovtojë se kush është i vërtetë në deklaratën e tij e kush është gënjeshtar. Ai që do të lëkundet nga ndonjë provë, Zotin nuk mund ta dëmtojë aspak dhe fatkeqësia e tij do ta çojë atë deri në xhebenem. Për të, më mirë do të ishte të mos lindte. Por, të gjithë ata që do të durojnë deri në fund, edhe pse do të përballen me vështirësi tronditëse, ngjarje të stuhishme dhe popujt do t’i përqeshin e shpotitin, madje edhe

*bota do të sillet shumë e inatosur me ta, përfundimisht do të fitojnë dhe atyre do t’ju hapen dyert e bekimeve”.*¹⁴

Kalifati Ahmedia – thekson Kalifi ynë – nuk ka mposhtur asnjë vend dhe nuk synon asnjë dominim politik, por ai ushtron ndikimin e tij mbi zemrat dhe mendjet e miliona njerëzve. Ai përbën një forcë për të mirën e botës, dhe e rrezaton atë me sjellje dinjitoze. Ai prapëseprapë mbetet një institucion i ngulitur fuqishëm mbi misionin e profetizmit.

Këtë fjalim po e mbylli me një konkluzion të shumë historianëve muslimanë e perëndimorë se katër kalifët e drejtë ishin plotësisht të drejtë dhe ndjekës të devotshëm të Profetit Muhammed^{savs}, por fundet e tyre tragjike sidomos të tre të fundit erdhën si pasojë se shumë ndjekës dhe drejtues rreth tyre u tunduan nga pushteti dhe pasuria, anuan pa u ndier nga bota dhe jo nga feja duke mos u bindur në heshtje kalifëve. Prandaj ta ruajmë si gjënë më të shtrenjtë këtë Kalifat, t’i bindemi Kalifit dhe të vlerësojmë më shumë

fenë se botën. Mesihu i Premtuar^{as}
porosit në librin e tij “Testamenti”:

*“Unë nuk shqetësohem se nga do të mbliidhen këto para..., por, unë shqetësohem se, pas kohës sonë, ata të cilëve do t’u liben këto para, të mos devijohen duke parë bollëkun e parave dhe të mos fillojnë ta duan botën. Ndaj lutem që Zoti gjithmonë t’i japë këtij Xhemati njerëz të besueshëm që do të punojnë për hir të Zotit”.*¹⁵
Amin!

Bibliografi

- 1 Mirza Ghulam Ahmed, “Filozofia e mësimave të Islamit”, përktheu në shqip: Muhamed Zekeria Khan, f. 134.
- 2 Kurani Famëlartë 2:31.
- 3 Kurani Famëlartë 24:56.
- 4 Kurani Famëlartë 2:39-40.
- 5 Kurani Famëlartë 12:104.
- 6 Kurani Famëlartë 2:64.
- 7 Kurani Famëlartë 6:152-154.
- 8 Kurani Famëlartë 38:27.
- 9 Kurani Famëlartë 60:13.
- 10 Ahmed Ibn Hanbel “Musned”, hadithi nr. 18406.
- 11 Kurani Famëlartë 62:3.
- 12 Fjalim i xhumasë me titull “Bekimet e Kalifatit”, i mbajtur më 29.05.2015.
- 13 Mirza Ghulam Ahmed, “Testamenti”, përktheu në shqip: Samad Ghori, Prishtinë 2011, fq. 7-8.
- 14 Po aty, fq. 12
- 15 Po aty, fq. 25.

Xhelsa Salana e 9-të e Xhematit Musliman Ahmedia të Shqipërisë



Mesihu i Premtuar^{as} duke u njoftuar prej Allahut të Madhëruar, kishte themeluar mbledhjen vjetore më 1891. Ky takim i përvitshëm bashkon të gjithë anëtarët e Xhematit, dhe u shërben për ngritjen e tyre shpirtërore e morale, shtimin e njohurisë fetare dhe vëllazërimin.

Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë mbajti Xhelsa Salanën e 9-të më 23 tetor 2016 në xhaminë

“*Bejtul-Evel*” në Tiranë. Përpos pjesëmarrësve nga Shqipëria, mysafirët kishin ardhur edhe nga Kosova.

Fjalimin e parë e mbajti z. Besmir Yveysi rreth temës “**Dashuria e vërtetë**”. Duke u ndalur te kuptimi leksikor, ai tha se dashuria e vërtetë është ajo që njeriu i shpreh Krijuesit të tij. Duke u bazuar në Kuranin Famëllartë, thënie të profetike dhe

shkrimet e Mesihut të Premtuar^{as} ai tregoi se ndjesia e dashurisë i ngjan asaj bërthame që rritet e zhvillohet në zemrën e njeriut, e pastaj duke pasqyruar atributet e Zotit, bëhet mishërim i vullnetit të Tij. Më tej, ai shpjegoi shenjat e dashurisë së vërtetë, pra, bukuria (druajtja ndaj Allahut dhe morale të larta), afërsia (në raport me Zotin e Lartësuar), lavdërimi (ndjekja e rrugës së Zotit dhe të të Dërguarit të Tij^{savs}), sakrifica (gatishmëria për çfarëdolloj sakrifice në dashurinë e Zotit) dhe asgjësimi (pranimi i sundimit të Zotit mbi të gjitha dëshirat dhe aspiratat personale) etj.

Pastaj z. Javid Iqbal Nasir mbajti fjalën e tij rreth **“Fisnikërisë dhe ndershmërisë së Profetit Muhammed^{savs}”**. Fillimisht duke shtjelluar kuptimet e këtyre vetive, ai nënvizoi se shfaqja më e lartë e këtyre attributeve vjen nëpërmjet të dërguarve të Zotit, ndërsa manifestimi më i arrirë dhe





më i pashembullt i tyre u rrezatua në modelin e Profetit Muhammed^{savs}. Më tej, ai rrëfeu disa ngjarje nga jeta fisnike e Profetit^{savs} të cilat nxirrnin në pah vetitë e fisnikërisë dhe ndershmërisë së tij. Ai tregoi ngjarjen e vendosjes së gurit të zi gjatë ndërtimit të Qabesë dhe dha disa shembuj për standardet e tij të larta të drejtësisë etj.

Pas një pauze të shkurtër, z. Muhamet Peci mbajti ligjëratë rreth temës **“Mësimet islame për edukimin e fëmijëve”**. Duke u bazuar në ajetet kuranore, ai tregoi rëndësinë e edukimit moral e shpirtëror të fëmijëve. Duke iu referuar një fjalimi të Hazret Kalifit II^{ra}, ai tërhoqi vëmendjen për të mësuar fëmijët që të kujdesen për kohën, për edukimin e tyre shpirtëror që në moshë të re, përzgjedhjen e shoqërisë së mirë për ta, dhe për t'i ushqyer ata me sakrificë e vetëmohim. Neglizhenca ndaj arsimit, edukimit dhe përkujdesjes

shëndetësore janë të barabarta me vrasjen e tyre. Derisa qëllimi i njeriut në këtë jetë është adhurimi i Zotit dhe përvetësimi i vetive hyjnore, prindërit duhet t'ua japin fëmijëve atë model që kontribuon në këtë drejtim. Ai përfundoi fjalimin e tij me një lutje të Kalifit II^{ra} për mbrojtjen e fëmijëve.

Fjalimi vijues u mbajt nga z. Bujar Ramaj rreth temës **“Nevoja e udhëheqjes në umetin musliman”**. Ai argumentoi se zgjidhja e vetme për gjendjen aktuale të muslimanëve është bashkimi i tyre në një dorë të vetme. Njeriu u krijua nga Zoti për t'u zhvilluar pafundësisht, dhe kjo arrihet në mënyrën më të shkëlqyer, kur arsyeja njerëzore ndriçohet nga shpallja hyjnore. Ky udhëzim hyjnor nuk kufizohet vetëm në aspektin e zhvillimit shpirtëror, por përfshin të gjitha anët e jetës njerëzore, megjithatë udhëzimi i vërtetë hyjnor vjen përmes të dërguarve të Zotit. Sot botën muslimane po e dëmtojnë rëndë sektarizmi e ekstremizmi, ndërsa mësimet jetëdhënëse të Kuranit dhe të Profetit^{savs} janë lënë në harresë në përgjithësi. Pas periudhës së artë të Profetit

Muhammed^{savs} dhe katër kalifëve të drejtë, muslimanët u udhëhoqën vetëm politikisht nga sistemet despotike e mbretërore, duke thëlluar hendek me udhëheqjen fetare. Pas kësaj analize, ai nënvizoi se ardhja e Mesihut të Premtuar^{as} dhe vendosja e Kalifatit në Xhematin e tij, sipas profecive të Profetit Muhammed^{savs}, ka krijuar atë udhëheqje shpirtërore që i nevojitej umetit musliman. Sot vetëm duke iu bashkuar këtij Xhemati, umeti mund të shfaqë denjësisht mësimet e vërteta të Islamit anëmbanë botës.

Fjalën e radhës e mori z. Samad Ahmad Ghori, i cili trajtoi temën **“Dexhalli dhe ardhja e Mesihut të Premtuar^{as}”** në mënyrë mjaft objektive dhe bindëse. Duke e shkoqitur konceptin e Dexhallit në bazë të haditheve, ai përshkroi edhe detyrat që ai do t'i kryente. Ai argumentoi se ekzistojnë vetëm dy mënyra për t'i kuptuar këto profeci dhe shenja. Pra, ose të pranohen në mënyrë shabllone, duke pritur ardhjen e një përbindëshi që posedon çuditërisht edhe disa fuqi mbinjerëzore, ose të konsiderohen



fjalë të urta të një Profeti urtiplotë^{savs}, dhe të interpretohen respektivisht. Me të vërtetë, shenjat që janë përshkruar në profecitë e dexhallit, parashikojnë zhvillimin e gjithanshëm të qytetërimit bashkëkohor, i cili i privuar nga spiritualiteti, përfaqëson materializmin. Shpikja e mjeteve të shpejta të transportit, armët bërthamore dhe kimike për një shkatërrim botëror, dhe zhvillimet revolucionare në bujqësi, mjekësi, meteorologji, mineralogji e shumë fusha të tjera dëshmojnë për përmbushjen e këtyre profecive. Fatkeqësisht, muslimanët në

përgjithësi duke mos kuptuar thelbin e dexhallit, nuk arritën të njihnin as figurën e Mesihut të Premtuar^{as}. Në fund, duke u bazuar në shkrimet e Imam Mehdiut^{as}, ai shpjegoi edhe ballafaqimin e dexhallit me Isain^{as}, birin e Merjemes.

Mandej, z. Bujar Ramaj prezantoi tri botimet e xhematit, përkatësisht “*Theuari i lutjeve*” të autorit Hafiz Muzaffar Ahmad, “*Pesë virtyte themelore*” dhe “*Sheriati – marrëdhënie mes fesë dhe politikës në Islam*” të autorit Hazret Mirza Tahir Ahmad.

Pas pushimit për namaz dhe drekë, nisi seanca e tretë me recitim

e Kuranit Fisnik nga z. Ilirian Ibrahim, i ndjekur me një ilahi nga z. Artan Mavraj. Pastaj z. Shahid Ahmad Butt trajtoi temën **“Alkooli dhe droga: një kërcënim për shoqërinë”**. Ai shpjegoi dallimet midis shoqërive shpirtërore dhe materialiste, dhe argumentoi se njeriu kur ndjekjen e dëshirave personale e quan qëllim të jetës, dhe kënaqësitë e përkohshme dhe të padobishme bëhen boshti i jetës së tij, atëherë dalëngadalë shoqëritë e tilla fillojnë të vuajnë nga ankthi dhe pakënaqësia. Alkooli dhe droga janë vetëm mjete që përdoren për të arritur kënaqësi të përkohshme, por dispozitat e Islamit i ndalojnë rreptësisht, urtësia e të cilave vërtetohet bindshëm edhe nga studimet mjekësore e shkencore.

Fjalimin mbyllës të Xhelsës e mbajti z. Muhammed Zakaria Khan, kryetar dhe kryemisionar i Danimarkës, rreth temës **“Lidhshmëria e Mesihut të Premtuar^{as} me Zotin e Lartësuar”**. Duke treguar pozitën e lartë të të Dërguarit të Allahut^{savs}, ai provoi se duke qenë njeri i përsosur, Profeti^{savs} mbarti

denjësisht amanetin e adhurimit. Ai gjithashtu rrëfeu ngjarje të shumta nga jeta e Profetit^{savs} që vërtetëtonin lidhjen e tij të pashembullt me Zotin. Shëmbëlltyra më e përkryer e kësaj lidhjeje në kohën tonë, ishte shërbëtori besnik i të Dërguarit të Allahut^{savs}, pra Mesihu i Premtuar^{as}. Ai gjithashtu paraqiti disa ngjarje besimshtytëse dhe fragmente nga shkrimet e tij, që tregonin besnikërinë e tij ndaj Allahut dhe Profetit Muhammed^{savs}. Xhelsa Salana përfundoi me lutje të heshtur.

Elhamdulillah, kjo mbledhje përfundoi me sukses. Risi e këtij viti ka qenë transmetimi i drejtpërdrejtë në internet i programit të xhelsës. Kësaj here, u zhvillua një ekspozitë rreth profecive dhe mësimëve të Kuranit. Lutemi që Allahu i Madhëruar t'i shpërblejë të gjithë pjesëmarrësit e xhelsës dhe t'i mundësojë për të sjellë ndryshime të çiltra shpirtërore në jetën e tyre. Allahu i Madhëruar e pranofte lutjen e Mesihut të Premtuar^{as} në favor të tyre. Amin!

Shahid Ahmad Butt

Xhelsa Salana e 5-të e Xhematit Musliman Ahmedia të Kosovës



Xhemati Musliman Ahmedia i Kosovës zhvilloi Xhelsa Salanën e 5-të më 29 maj 2016 në sallën e hotelit Amazona në Prishtinë. Në këtë xhelse, që u zhvillua pas një pauze gjashtëvjeçare, morën pjesë delegatët që kishin ardhur nga Gjermania, Shqipëria dhe Maqedonia. Ndër mysafirë të shquar ishin Abdullah Uwe Wagishauser, Amir i Gjermanisë dhe Muhammad

Zakaria Khan, Amir i Xhematit të Danimarkës.

Për mbarëvajtjen e programit, z. Alban Zeqiraj ishte ngarkuar me detyrën Oficer Xhelsa Salana, ndërsa z. Shkëlqim Bytyçi me detyrën Oficer Xhelsa Gah, ndërsa këta kishin ndarë detyrat e tyre në disa departamente. Të gjithë pjesëtarët e Xhematit kontribuan në organizimin e xhelsës.



Fillimisht z. Rexhep Hasani prezantoi agjendën e xhelsës, e më pas tregoi për rëndësinë dhe qëllimet e këtij tubimi. Z. Abdullah Uwe Wagishauser, Amir i Gjermanisë, udhëhoqi seancën e parë. Programi filloi me recitimin e Kuranit nga z. Besmir Yvejsi, i cili këndoi bukur ajetet 103-106 të sures Ali Imran. Më pas, z. Artan Mavraj recitoi vjershën e Mesihut të Premtuar as me titull “Përsbkrimi i gjendjes së mjerueshme të muslimanëve dhe lutje plot dhimbje për triumfin e Islamit”. Po citojmë disa vargje të kësaj vjershe:

Arka e Islamit me pambështetje hyjnore, ja po fundoset

Bëj diçka o marrëzi, mendjet nuk po ia dalin!

Më ndiz në zemër një zjarr për umetin

Flakët e të cilit të arrijnë pafundësisht gjer në qiell

Nuk mund të shoh kurrësi dobësinë e fesë së Muhammedit

O Sunduesi im, jepmë sukses dhe ngadhënjim

Bekoje Islamit, o Zoti im, Vetë shpëtoje atë

Dëgjoje klithmën e robërve të kësaj varke të thyer.

Fjalimi i parë u mbajt nga z. Muhammed Zakaria Khan sahib rreth temës “Lutje dhe përpjekje”. Ai nënvizoi rëndësinë e përpjekjes në jetën e besimtarit, dhe shtoi se edhe nëse disa rezultate mund të arrihen vetëm me anë



të përpjekjeve tona, por lutja luan rolin e katalizatorit duke siguruar që rezultatet të jenë më të mëdha e më të begatshme. Pastaj, duke rrëfyer jetën e të dërguarve të Zotit, ai theksoi se lutja dhe përpjekjet shkojnë bashkë me njëri-tjetrin. Ai përmendi ngjarje nga jeta e Nuhut^{as}, Ibrahimit^{as}, Jusufit^{as}, Musait^{as}, Junusit^{as}, Zekeriat^{as}, Isait^{as}, si dhe të Dërguarit të Allahut Muhammedit^{savs}, dhe argumentoi se lutja është ai mjet që shndërron të pamundurën në të mundur. Në fund, ai dha shembuj nga jeta e Mesihut të Premtuar as që dëshmuar se vetëm lutjet e sinqerta, mund t'u japin rezultate orvatjeve tona.

Fjalimi i dytë u mbajt nga prof. Muhamet Peci mbi temën “Si mund të arrijmë vëllazërinë e vërtetë?”. Fillimisht, ai citoi porositë e Kuranit Famëllartë dhe të Profetit^{savs} rreth vëllazërisë.

Në fjalën e tij, ai recitoi hadithe të shumta profetike, që mbanin këshilla të arta për të arritur vëllazërinë e vërtetë. Nëse smira, urrejtja, nënçmimi dhe padrejtësia janë pengesa për vëllazërinë, dashuria, drejtësia dhe devotshmëria janë kushtet e saj të domosdoshme. Ai citoi disa ngjarje emocionuese të sahabëve të Profetit^{savs} të cilët për hir të dashurisë dhe vëllazërisë së ndërsjellë, sakrifikuan për njëri-tjetrin me vetëmohim të plotë. Në fund të fjalës, ai tregoi rëndësinë e *takvasë* që përbën bazën e përsosmërisë së njeriut, dhe pa të cilën nuk mund të arrihet vëllazëria e vërtetë.

Pas këtij fjalimi, z. Besmir Yveysi prezantoi numrin 8 të revistës “Vërtetësia” me temat kushtuar rëndësisë së agjërimit dhe muajit të shenjtë Ramazan.

Pas një pauze të shkurtër, nisi seanca e dytë e xhelsës me recitim të disa ajeteve të Kuranit nga z. Bekim Bici, ndjekur nga një vjershë e Mesihut të Premtuar^{as} që e recitoi z. Mentor Ismajli. Disa prej vargjeve të kësaj vjershe janë si më poshtë:

*Kam një lutje, O Udhëheqësi im
Të pragu Yt po qaj me përgjërëm
Evolatin tim që është dhuratë nga Ti
Unë t'i shoh të dëlirë, gjithsecilin
Ata nga papastërtia liroji
Robërit e Tu të përsosur bëji
Të jenë të ngazëllyer e bekimplotë
Nga jeta gjynahqare shpëtoji, o Zot!*

Fjalimin e radhës mbajti z. Alban Zeqiraj mbi temën “Ngjashmëria midis xhemateve shpirtërore”. Në fjalën e tij, ai ndaloi në aspektin e persekutimit dhe rrëfeu ngjarje rrëqethëse të shtypjes së sahabëve të Profetit Muhammed^{savs}, që shërbyen si stimulues për besimin e tyre. Pastaj, duke treguar profecitë e Profetit^{savs} për ringjalljen e Islamit në ditët e mëvonshme, ai bëri përqasje midis xhematit të të Dërguarit të Allahut^{savs} dhe shërbëtorit të tij Mesihut të Premtuar^{as}. Ai rrëfeu ngjarjen e Sahibzade Abdul-Latif sahibit, i cili u martirizua në mënyrë barbare, vetëm se kishte pranuar Imamin e kohës. Pavarësisht të gjitha vështirësive dhe sakrificave, ky xhemat do të përparojë katërçipërisht duke ngritur lart nderin e Profetit Muhammed^{savs}.

Më pas z. Ridvan Ismajli iu drejtua sallës me temën **“Besnikëria ndaj atdheut”**. Ai ndau fjalën e tij në analizën e situatës aktuale të botës, dhe në kuptimin e besnikërisë ndaj atdheut në bazë të fesë islame. Ai tregoi se sot një pjesë e liderëve politikë u japin epërsi interesave të tyre personale, përballë atyre kombëtare. Pastaj, ai tregoi mësimet e Islamit nga Kurani dhe Hadithi për besnikërinë ndaj atdheut. Ai theksoi rëndësinë e drejtësisë për zhvillimin e vendit, si dhe detyrën e besimtarëve për të shfaqur besnikëri të palëkundshme ndaj atdheut. Ai citoi edhe disa pjesë nga fjalimi i Kalifit V^{a.b.a.} mbi të njëjtën temë të mbajtur më 2012 në Gjermani.

Pas përfundimit të këtij fjalimi, besimtarët kryen namazet në sallë dhe u shtrua drekë për të gjithë pjesëmarrësit.

Seanca e fundit e xhelsës u nis me recitimin e ajeteve 55-56 të sures en-Nur nga z. Shahid Ahmad Butt. Më pas z. Bekim Bici recitoi disa vargje të një vjershe të Mesihut të Premtuar^{as}. Më pas z. Bujar Ramaj mbajti fjalim rreth temës **“Kalifati**

i drejtë dhe rivendosja e tij”. Ai shpjegoi se Kurani Famëlartë jep mësimet për përsosjen e njeriut, me qëllim që ngjizja e çdo lloji sistemi, qoftë shpirtëror, politik apo shoqëror të bëhet përmes tij. Ai tha se mbarëvajtja e çdo sistemi varet nga marrëveshja e individit apo shoqërisë me Zotin. Ai nënvizoi se sipas Kuranit, pa krijuar sundimin shpirtëror nuk mund të ndërtohet asnjë sistem politiko-ekonomik. Në vazhdë të fjalës, ai argumentoi se sot vetëm Kalifati Ahmedia paraqet atë sistem të lartë shpirtëror, i cili drejton umetin e Profetit Muhammed^{savs} në rrugën e Islamit të vërtetë dhe po përhap botërisht mesazhin paqësor të Islamit.

Në fund z. Abdullah Uwe Wagishauser mbajti fjalimin mbyllës rreth temës **“Roli i Kalifatit në vendosjen e paqes botërore”**. Ai tregoi për kontradiktat që gjenden në politikën botërore. Ai theksoi se sipas Kuranit, i vetmi ilaç për të shndërruar frikën në paqe, është vendosja e Kalifatit. Dështimi i të gjitha sistemeve dhe organizatave botërore për vendosjen e paqes në

botë, dhe rreziku i një lufte të tretë botërore, lypin për një zgjidhje hyjnore. Sigurisht, Zoti dërgoi Imam Mehdiun^{as} për vendosjen e paqes në botë, dhe këtë mision kanë përcjellë katërçipërisht kalifët e tij. Duke përshkruar veprimtarinë dhe metodologjinë e grupeve terroriste në emër të Kalifatit, ai argumentoi se ata nuk kanë asnjë lidhje me Islamin e vërtetë, i cili promovon vetëm lidhjen me Zotin, paqen dhe urtësinë. Ai citoi disa thënie të Mesihut të Premtuar^{as} dhe theksoi se vetëm përmes mësimave të Islamit të bazuara në drejtësi e barazi, që janë paraqitur prej tij, mund të arrihet vëllazëria universale. Është vetëm zëri i Kalifit të Kohës, i cili bën thirrje për paqen duke kërkuar zbatimin e parimeve islame, dhe pa iu përmbajtur udhëzimeve të Kalifit, bota kurrë nuk mund të gjejë paqen e vërtetë.

Pas fjalimit të Amir sahibit, z. Valdon Mustafa shprehu mirënjohje dhe falënderime.

Xhelsa Salana përfundoi me lutje të heshtur. Elhamdulillah, Xhelsa përfundoi me sukses. Allahu i

bekoftë të gjithë të pranishmit, dhe e pranofte lutjen e Mesihut të Premtuar^{as} në favor të tyre. Amin!

Shahid Ahmad Butt

Index in English

“In the name of Allah the Gracious, the Merciful”	4
Commentary of the Holy Quran By Hazrat Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmad ^{ra} , Al Muslih Mauod & Khalifatul Masih II	
Forgiveness is in God’s Hands	15
Hadith of the Holy Prophet ^{saw}	
The Muslim Leader: “The UNO must also play its role in establishing peace in the world, unencumbered by politics, injustice or favouritism.”	16
A report about the historic address of Hazrat Khalifatul Masih V ^{a.t.b.a.} in the Canadian Parliament	
“Perish the thought of <i>Jihad</i>, O friends”	30
Albanian Translation of the poem of the Promised Messiah ^{as}	
The Need for Searching the Faith and the Jama’at of God	34
Sayings (<i>Malfuzaat</i>) of the Promised Messiah ^{as}	
Some of the Prophecies of the Holy Prophet^{saw} about this Time and Age	38
Dr. Mirza Sultan Ahmad	
The Anti-Christ and the Advent of the Promised Messiah	48
Samad Ghori	

Verses of the Holy Quran about this Time and Age.....	58
Prophecy of the Promised Messiah^{as} regarding the World Wars.....	62
Albanian Translation of some of his Urdu verses	
Q/A: How you understand the term <i>Khatamun-Nabiyyeen</i>?.....	64
What is the difference between you and other Muslims in understanding this term?	
<i>Majlis-e-Irfan</i> of Hazrat Mirza Tahir Ahmad ^{ra} , Khalifatul Masih IV	
“The True Khilafat” and its Re-institution.....	74
Dr. Bujar Ramaj	
A report about 9th Jalsa Salana of Albania.....	87
Shahid Ahmad Butt	
A report about 5th Jalsa Salana of Kosovo.....	93
Shahid Ahmad Butt	

PORTALI I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA NË SHQIP

www.alislam.al



KREU

ISLAMI

AHMEDIATI

FJALIMET E XHUMAVE

ARTIKUJT

LAJME

LUTJET

LIBRAT

VIDEO

KONTAKTONI



Komunikimi me Zotin është esenca e Islamit

Fjalimet e fundit të xhumave nga Kalifi i Islamit



17/03/2017 | Hazret Mirza Masrur Ahmed (aba)

Ekstremizmi dhe persekutimi



10/03/2017 | Hazret Mirza Masrur Ahmed (aba)

Detyrat e misionarëve, të

Lajmet



10/03/2017 | Zyra e shtypit dhe e medias

**Kalifi i XhemaTit Musliman
Ahmedia u drejtohet të
dedikuarve të skemës "Vakf-e-
nau", në Londër**



09/01/2017 | Zyra e shtypit dhe e medias

**Hazret Mirza Masrur Ahmed
përuroi xhaminë Bejtul-Ehsan në
Londër**



KËRKONI

Search...

Go

ISLAMI

feja që përfaqëson kulmin
e zhvillimit fetar.



Allahu i Madhërishëm
i Vetëm dhe i Pashoq

PROFETI I SHENJTËS

i Dërguarit i Zotit dhe Vula e profetëve



Muhammed^ﷺ
Shembulli më i përkryer

AHMEDIATI

Ahmedia është rilindja e parashikuar e islamit
për të bashkuar njerëzimin në Ditët e Vonës.



**Hazret Mirza Ghulam
Ahmed i Kadjanik**^ﷺ
Meshti i Premtuar dhe
Imam Mehdi

KATEGORIA E ARTIKUJVE

Artikuj

Fjalime

Letërkëmbime

Poezi

Reportazhe

Malfuzat – Thëniet e Mesihut të Premtuar
as.

KATEGORIA E LUTJEVE

Lutjet e Kuranit


Lutjet e të Dërguarit të Allahut s.a.

Lutjet e Mesihut të Premtuar as.

Lutjet e Kalifëve

Dashuri për të gjithë urrejtje për askënd

www.alislam.al



“Vërtetësia” (The Truthfulness) is a periodical Albanian magazine published by Ahmadiyya Muslim Jama’at of Albania.
For index in English, see page 99.
